# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5514
E shtunë, 30 qershor 2018
çmimi 0.40 €


## Thaçi, opozitës: Eja jepe dijen dhe patriotizmin në tryezë të bisedimeve

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de




FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI FAQE 4-5

# Diplomacia e Kosovës duhet të jetë më aktive

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka vlerësuar se diplomacia e Kosovës ka nevojë për një riorganizim më të mirë bazuar në kualitete e meritokraci dhe jo në nepotizëm e përkatësi partiake. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se diplomacia duhet të jetë më aktive, më e koordinuar dhe më e efektshme ndaj ofensivës serbe kundër njohjes së Kosovës. Duke folur për procesin e liberalizimit të vizave, Gashi ka thënë se pret rekomandim pozitiv dhe, sipas tij, çdo vendim tjetër do të ishte zhgënjyes. Sa i përket dialogut me Serbinë, ai ka thënë se ky proces kërkon unitet, konsensus dhe konstruktivitet institucional. Gashi i ka bërë thirrje Kuvendit të jetë më i impenjuar për dialogun dhe të vendosë për formatin e bisedimeve të kësaj faze

PRESIDENTI I ASAMBLESË PARLAMENTARE TË NATO-S, PAOLO ALLI, PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË FAQE 3

## Paolo Alli: Transformimi i FSK-së, përmes ndryshimeve kushtetuese



Presidenti i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Paolo Alli, ka thënë se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri do të ishte mirë të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese. Në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Ramush Haradinaj ai ka thënë se prania e NATO-s në Kosovë i kontribuon stabilitetit rajonal. Ndërkaq kryeministri Haradinaj ka thënë se FSK-ja ka përmbushur kapacitetet operative drejt transformimit në Forcën e Armatosur, në bashkërendim me partnerët ndërkombëtarë



## Mësimdhënësit me doracak për luftimin e ekstremizmit

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, me rastin e promovimit të doracakut për mësimdhënës "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm", ka theksuar se ky doracak ka për qëllim t'u ofrojë mësimdhënësve në mbarë Kosovën udhëzime teknike për adresimin e sfidave konkrete të nxitura nga ekstremizmi i dhunshëm në shkollat tona

FAQE 7

### AKTUALE

**VITIN TJETËR NË... FUND TË PUSIT!** F. 11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**MË SHUMË HISE NË 'KULETËN' E NATO-s** F. 11



Shkruan: Agron HOTI

**O'CONNELLI FTON PARTITË POLITIKE TË ANGAZHOHEN NË FAZËN E RE TË DIALOGUT** F.3

### EKONOMI

**ODA AMERIKANE: MOS TË LEJOHET IMPORTI I VETURAVE MË TË VJETRA SE 10 VJET** F. 9

### KULTURË

**DRENICA NË KRYENGRITJET E VITEVE 1913-1914 DHE TERRORI SERB NDAJ SHQIPTARËVE** F. 10

Dr. sc. Fitim RIFATI

### SPORT

**LORIANA KUKA, E ARGJENDTË NË LOJËRAT MESDHETARE** F. 18

**'NXEHET' KUPA E BOTËS, FILLON FAZA E ELIMINIMIT TË DREJTPËRDREJTË** F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Ambasadorja Çitaku: Kosova është me fat që ka mbështetjen e ShBA-së



UASHINGTON, 29 QERSHOR- Ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), Vlora Çitaku, është takuar me sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo. Ajo ka thënë se Pompeo e njeh mirë Kosovën dhe se vendi ynë është me fat që në vazhdimësi e ka pasur mbështetjen amerikane. "Pata kënaqësinë ta takoj sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo. Sekretari Pompeo e njeh shumë mirë Kosovën dhe ne jemi me fat që kemi pasur dhe e kemi mbështetjen e ShBA-së, pavarësisht prej ndryshimeve në administratën amerikane", ka shkruar Çitaku në llogarinë e vet në "Facebook".

Promovohet doracaku për mësimdhënës "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm"

# Mësimdhënësit me doracak për luftimin e ekstremizmit

**Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, me rastin e promovimit të doracakut për mësimdhënës "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm", ka theksuar se ky doracak ka për qëllim t'u ofrojë mësimdhënësve në mbarë Kosovën udhëzime teknike për adresimin e sfidave konkrete të nxitura nga ekstremizmi i dhunshëm në shkollat tona**




EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të premten në promovimin e doracakut për mësimdhënës "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm", i përgatitur nga MAShT-i me ndihmën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Fondacionin Evropian për Demokraci (FED), si dhe mbështetjen financiare të Ambasadës së Italisë në Kosovë.
Ministri Bytyqi me këtë rast ka theksuar se rëndësia e arsimit në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm nuk është e përcaktuar vetëm me Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015/20, por është avancuar nga praktikat më të mira të OKB-së dhe praktikat e tjera ndërkombëtare për ndërtimin e mbrojtjes së rinisë ndaj ideologjive ekstremiste të dhunshme.
Ministri Bytyqi ka theksuar se ky doracak ka për qëllim t'u ofrojë mësimdhënësve në mbarë Kosovën udhëzime teknike për adresimin e sfidave konkrete të nxitura nga ekstremizmi i dhunshëm në shkollat tona. "Arsimi luan rol të rëndësishëm në parandalimin e radikalizmit, duke nxitur zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik tek nxënësit, duke ndërtuar besimin dhe aftësitë jetësore dhe duke parë votën nga perspektiva e një qytetari global. Doracaku është një nga disa aktivitetet që MAShT-i ka iniciuar për t'i arritur objektivat e përcaktuara në Strategjinë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm", ka thënë ministri Bytyqi.
Ministri Bytyqi ka falënderuar UNDP-në, FED-in për ndihmën që sot të kemi një doracak, i cili do t'i ndihmonte mësimdhënësit në mënyrë që hapat e parë të ndalimit të ekstremizmit të dhunshëm t'i kemi te të rinjtë.
Ambasadori i Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi, ka thënë se luftimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe kundërvënia ndaj terrorizmit është një prej sfidave më madhore të kohës sonë dhe se për to duhet vëmendje jashtëzakonisht e madhe dhe duhet të trajtohen njerëz përmes strategjive të ndryshme për parandalim dhe luftim të ekstremizmit.
Ndërsa përfaqësuesja e UNDP-së, Ulrika Richardson, ka folur për rëndësinë e doracakut dhe rëndësinë e zbatimit të tij në shkolla, në mënyrë që të rinjtë tanë të njoftohen lidhur me rreziqet të cilat çojnë në ekstremizëm dhe radikalizëm.



# Certifikohen 20 zyrtarë policorë të Kosovës

FUSHË-KOSOVË, 29 QERSHOR - Në bazën "MSU Carabinieri" në Fushë-Kosovë është mbajtur të premten ceremonia e certifikimit të 20 zyrtarëve policorë, të cilët me sukses kanë përfunduar trajnimin, i cili i dedikohej "luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm".
Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë menaxhmentin e Policisë së Kosovës, KFOR-it, si dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, i cili ishte pjesë e ndarjes së certifikatave për zyrtarët policorë.
Ky trajnim i ofruar nga "Carabinieri MSU" është financuar nga Bashkimi Evropian përmes projektit "mbështetje e mëtejshme institucioneve të Kosovës".
Policia e Kosovës këto trajnime i ka vlerësuar mjaft të nevojshme dhe të dobishme për zyrtarët policorë.

## Liberia akrediton ambasadorin jorezident të Kosovës



PRISHTINË, 29 QERSHOR- Ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli, ka njoftuar se Liberia ka akredituar atje ambasadorin jorezident të Kosovës, Ramadan Gashin. "Ndihem mirë që vetëm një ditë pas vizitës sime në Monrovia të Liberisë, mora notën verbale me të cilën ky shtet përgjigjet në favor të Kosovës për akreditimin e ambasadorit tonë jorezident (Ramadan Gashin nga Senegali) në këtë shtet. Marrëdhëniet me Liberinë vetëm do të thellohen si në rastin e dy shteteve të tjera për të cilat Serbia pretendonte se kanë tërhequr njohjet për Kosovën", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Paolo Alli, po qëndron për vizitë në Kosovë

# Paolo Alli: Transformimi i FSK-së, përmes ndryshimeve kushtetuese

Presidenti i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Paolo Alli, ka thënë se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri do të ishte mirë të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese. Në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Ramush Haradinaj ai ka thënë se prania e NATO-s në Kosovë i kontribuon stabilitetit rajonal. Ndërkaq kryeministri Haradinaj ka thënë se FSK-ja ka përmbushur kapacitetet operative drejt transformimit në Forcën e Armatosur, në bashkërendim me partnerët ndërkombëtarë



EPOKA E RE Faton DERMAKU

Prishtinë, 29 qershor - Presidenti i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Paolo Alli, është takuar të premten me presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Në këto takime zyrtari i lartë i NATO-s ka biseduar për misionin e KFOR-it në vendin tonë, për kontributin që NATO-ja po jep për stabilitetin, sigurinë dhe paqen në rajon dhe për procesin e reformës që është e nevojshme për anëtarësim e Kosovës në NATO.

Alli kur është pyetur për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forca të Armatosura të Kosovës ka thënë se mënyra më e mirë për transformimin e FSK-së në ushtri do të ishte mirë të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese. "NATO-ja konsideron se transformimi duhet të ndodhë në respektimin e kushtetueses. Gjithashtu, mendojmë se mënyra më e mirë është reforma kushtetuese. NATO-ja është këtu dhe do të jetë këtu", ka thënë Alli.

Ai ka pohuar se NATO-ja dhe Kosova kanë një lidhje të fortë prej shumë vitesh dhe ka theksuar rëndësinë e vazhdimit të përparimit të Kosovës në rrugën drejt anëtarësimit në NATO. "Jam këtu sot si president i Asamblesë Parlamentare të NATO-s për të vërtetuar edhe një herë se Asambleja Parlamentare është shumë e afërt me Kosovën, është shumë e lidhur dhe e përkushtuar me Ballkanin Perëndimor, sepse ne mendojmë se Ballkani Perëndimor është pjesë esenciale e Evropës", ka thënë Alli në një konferencë për medie pas takimit me kryeministrin Ramush Haradinaj.

Ai ka thënë se janë duke bërë më të mirën për t'i mbështetur përpjekjet që Kosova është duke bërë në procesin e reformës, që është e nevojshme për anëtarësim në NATO. "Ne shohim progres real, ne shohim se ka punë për t'u bërë, veçanërisht për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, por ne jemi të sigurt se udhëheqja juaj është shumë e fuqishme dhe ju do të keni sukses në rrugëtimin tuaj për integrim euroatlantik", është shprehur Alli, duke theksuar se prania e misionit të KFOR-it, përpjekja që NATO ka bërë në vitet e kaluara për të kontribuar në stabilitet, në siguri dhe paqe, është dëshmi se Kosova dhe Ballkani Perëndimor duhet të jenë më afër Evropës.

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se e gjithë perspektiva e rajonit tonë është një fjalë anëtarësimi në NATO. "Ashtu sikurse vendet e tjera, edhe Kosova në NATO e sheh sigurinë dhe paqen e përjetshme", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Duke theksuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me NATO-n, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova i gëzohet ardhjes së presidentit të Asamblesë Parlamentare, ku edhe Kosova ka statusin e vëzhguesit.

Në takim, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova dhe populli i saj do t'i jetë përjetë mirënjohës dhe asnjëherë nuk do ta harrojë ndihmën që NATO ka dhënë në të gjitha fazat e shtetndërtimit.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar rolin e rëndësishëm të NATO-s në garantimin e paqes dhe të sigurisë dhe e ka vlerësuar forcën paqeruajtëse të KFOR-it si një partner të rëndësishëm në Kosovë. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka thënë se Forca e Sigurisë së Kosovës, e mbështetur nga NATO-ja në çdo periudhë të ndërtimit, ka përmbushur kapacitetet operative drejt transformimit në Forcën e Armatosur, në bashkërendim me partnerët ndërkombëtarë.

## Thaçi: Është koha që edhe Kosova të jetë në NATO



Edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të premten në takim delegacionin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili kryesohej nga Paolo Alli, president i Asamblesë. Presidenti Thaçi ka shprehur falënderimin e tij për vizitën, bashkëpunimin dhe përkrahjen që i ka dhënë Kosovës Asambleja Parlamentare e NATO-s. "Kosova është faktor stabiliteti në rajon, e përkushtuar për dialog me Serbinë që do të sjellë paqe të qëndrueshme në tërë rajonin", ka shtuar ai.

Kosova, sipas presidentit, e mirëpret rikthimin e vëmendjes së BE-së në rajonin e Evropës Juglindore, me strategjinë dhe Samitin e Sofjes. "Rezultate konkrete të menjëhershme janë zgjidhja e kontestit të emrit në mes të Greqisë e Maqedonisë si dhe fillimi i fazës përfundimtare të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë ai. Duke folur për kërcënimin global nga terrorizmi, presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova është liderë në rajon në luftimin e ekstremizmit e radikalizmit.

Ndërsa Paolo Alli, president i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, është shprehur i kënaqur me bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës. Në fund, presidenti Thaçi ka thënë se NATO është në Kosovë, por tani është koha që edhe Kosova të jetë në NATO. Sipas tij, FSK-ja është e gatshme për transformim në një forcë profesionale.

# O'Connelli fton partitë politike të angazhohen në fazën e re të dialogut



Prishtinë, 29 qershor (ER)- Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, u ka bërë thirrje partive kryesore politike të përfshin në fazën finale të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se Britania e mbështet shefen për politikë të jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, për t'i ndihmuar dy shtetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. "Gati 20 vjet pas konfliktit, Kosova dhe Serbia janë mbajtur prapa nga mungesa e një marrëdhënie normale me njëratjetrën. Ne mbështesim me forcë përpjekjet e Mogherinit për t'i ndihmuar Kosovën dhe Serbinë t'i zgjidhin dallimet e tyre dhe të bëjnë një marrëdhënie të re dhe më të mirë. Është pozitive që këto përpjekje po hyjnë në një fazë të re. Kosova duhet të krijojë struktura për t'u angazhuar në këtë proces, në mënyrë që çdo rezultat të mund të zbatohet dhe ta gëzojë besimin e qytetarëve të Kosovës. Ne u bëjmë thirrje të gjithë aktorëve politikë të bëjnë çfarë munden që Kosova të angazhohet seriozisht në fazën e re të dialogut", ka shkruar O'Connelli në llogarinë e vet në "Facebook".

Flet për "Epokën e re", Ibrahim Gashi

# Diplomacia e Kosovës d



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka vlerësuar se diplomacia e Kosovës ka nevojë për një riorganizim më të mirë bazuar në kualitete e meritokraci dhe jo në nepotizëm e përkatësi partiake. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se diplomacia duhet të jetë më aktive, më e koordinuar dhe më e efektshme ndaj ofensivës serbe kundër njohjes së Kosovës. Duke folur për procesin e liberalizimit të vizave, Gashi ka thënë se pret rekomandim pozitiv dhe, sipas tij, çdo vendim tjetër do të ishte zhgënjyes. Sa i përket dialogut me Serbinë, ai ka thënë se ky proces kërkon unitet, konsensus dhe konstruktivitet institucional. Gashi i ka bërë thirrje Kuvendit të jetë më i impenjuar për dialogun dhe të vendosë për formatin e bisedimeve të kësaj faze

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe njohësi i proceseve politike, Ibrahim Gashi, ka thënë të premten se diplomacia e Kosovës duhet të jetë më aktive, më e koordinuar dhe më e efektshme ndaj ofensivës serbe kundër njohjes së pavarësisë së shtetit të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se diplomacia ka nevojë për një riorganizim më të mirë bazuar në kualitete e meritokraci dhe jo në nepotizëm e përkatësi partiake. "Diplomacia, sikundër edhe ushtria e një shteti, duhet të jenë mbipartiake. Ka shumë diplomatë tashmë të dëshmuar që Ministria e Punëve të Jashtme nuk i angazhon në tërë kapacitetin e tyre dhe shumë të tjerë me kualitete të munguara që marrin detyra dhe përgjegjësi të larta", është shprehur Gashi.

Kurse sa i përket dialogut për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, ai ka thënë se ky proces në këtë fazë kërkon unitet, konsensus dhe konstruktivitet mbarinstitucional. Gashi ka bërë thirrje që edhe partitë opozitare të përfshihen në dialog. "Ajo nuk duhet të lihet, por as të qëndrojë jashtë këtij procesi. Pra, opozita sinqerisht duhet të ftohet për të kontribuar në këtë proces, ndërsa ajo nga ana e saj duhet sinqerisht ta ndihmojë procesin, pa pretenduar që në një çështje madhore si kjo të kalkulojë përfitime politike, duke mos marrë asnjë përgjegjësi. Përfshirja e gjerë në proces, konform kapacitetit legal të secilit institucion, si dhe transparenca e llogaridhënia janë të domosdoshme. Kuvendi (pozitë e opozitë) duhet të jetë më shumë i impenjuar me këtë çështje dhe ai duhet të vendosë si do të jetë formati i bisedimeve në këtë fazë", ka deklaruar ai.

Në këtë intervistë Gashi ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave, duke thënë se pret rekomandim pozitiv. Sipas tij, çdo vendim tjetër do të ishte zhgënjyes.

**"Epoka e re":** *Z. Gashi, Kosova dhe Serbia tashmë kanë nisur fazën finale të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy popujve. Si e shihni epilogun e këtij procesi, ka shanse të arrihet marrëveshja e pajtimit?*

**Gashi:** Konsideroj se dialogu me Serbinë që nga fillimi nuk ka qenë i lehtë. Prej fillimit pala serbe ka mbajtur qëndrime

# uhet të jetë më aktive



mohuese ndaj shtetit të Kosovës, ani pse ka nënshkruar një numër të marrëveshjeve, të emërtuara si marrëveshje për çështje teknike. Ç'është e vërteta, përmes këtyre marrëveshjeve, edhe pse vetëm pjesërisht të zbatuara, është arritur një shkallë relative e shtensionimit të marrëdhënieve midis dy shteteve. Tani kur, siç po thuhet, kemi hyrë në fazën finale të dialogut, bisedimet do të bëhen më të vështira dhe vendimet për marrëveshje do të jenë tërësisht politike. Serbia është e interesuar të fitojë në kohë, duke gjetur çfarëdo arsye për ta prolonguar arritjen e ndonjë marrëveshje përfundimtare që do të kishte si produkt njohjen e shtetit të Kosovës. Mendoj se ajo do të jetë e interesuar të gjejë, apo inskenojë çfarëdo preteksti për ta akuzuar palën e Kosovës si fajtore për ndërprerjen apo shtyrjen e bisedimeve. Kjo nënkupton se ne duhet të jemi të vëmendshëm dhe të përgatitur që të shmangim çfarëdo skenari serb për ndërprerjen e bisedimeve me fajin e Prishtinës.

**"Epoka e re":** *Megjithatë, në Kosovë ende nuk është arritur konsensusi i gjerë politik që presidenti Thaçi t'i vazhdojë bisedimet me presidentin Vuçiq. Duke pasur parasysh kundërshtimin e partive opozitare për ta mbështetur Thaçin në këtë dialog, ka gjasa të arrihet konsensusi dhe të formohet një ekip i unitetit, pjesë e të cilit do të ishte i gjithë spektri politik?*

**Gashi:** Procesi i dialogut, veçmas në këtë fazë kërkon unitet, konsensus, por edhe konstruktivitet politik mbarë institucional. Secili subjekt politik, por edhe shoqëria civile dhe media, duhet të vihet në funksion të mbrojtjes dhe të afirmimit sa më të madh të interesave të shtetit dhe të qytetarëve të Kosovës. Nëse e kemi identifikuar se afirmimi i plotë i shtetit të Kosovës do të ndodhë pas normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë si parakusht për anëtarësim të Kosovës në OKB, atëherë të gjithë duhet ta ndihmojmë këtë proces. Kjo nënkupton se në radhë të parë Qeveria, Kuvendi dhe presidenti duhet të punojnë ngushtë tani e tutje lidhur me dialogun. Kur them Kuvendi mendoj edhe në opozitën. Ajo nuk duhet të lihet, por as të qëndrojë jashtë këtij procesi. Pra, opozita sinqerisht duhet të ftohet për të kontribuar në këtë proces, ndërsa ajo nga ana e saj duhet sinqerisht ta ndihmojë procesin, pa pretenduar që në një çështje madhore si kjo të kalkulojë përfitime politike, duke mos marrë asnjë përgjegjësi. Përfshirja e gjerë në proces, konform kapacitetit legal të secilit institucion, si dhe transparenca e llogaridhënia janë të domosdoshme. Kuvendi (pozitë e opozitë) duhet të jetë më shumë i impenjuar më këtë çështje dhe ai duhet të vendosë si do të jetë formati i bisedimeve në këtë fazë.

**"Epoka e re":** *Përderisa në Bruksel po vazhdon ky dialog, në anën tjetër Serbia ka nisur një fushatë kundër njohjeve të Kosovës, madje nga vende të ndryshme të botës po kërkon t'i tërheqin vendimet për njohjen e pavarësisë. Si duhet t'i kundërpërgjigjet Kosova kësaj ofensive të diplomacisë serbe?*

**Gashi:** Serbia që nga 17 shkurti i vitit 2008 nuk ka reshtur së punuari për minimin e pavarësisë së Kosovës, e sidomos në planin ndërkombëtar. Fatmirësisht, efektet e këtij lobimi serb jo gjithmonë kanë arritur efektet e tyre, edhe për faktin e mbështetjes së madhe të diplomacisë së shteteve të fuqishme mike të Kosovës, por edhe falë aktiviteteve të diplomacisë së Kosovës. Kjo e fundit ka mundur dhe mund të jetë më aktive, më e koordinuar dhe më e efektshme. Duhet më shumë aktivitete të diplomacisë zyrtare të shtetit të Kosovës, të diplomacisë parlamentare, edhe të diplomacisë publike.

**"Epoka e re":** *Çfarë vlerësimi keni për punën e diplomacisë së shtetit të Kosovës gjatë kësaj periudhe qeverisës, ku nuk ka pasur shtim të numrit të njohjeve si dhe anëtarësim të vendit në organizata ndërkombëtare? Cili duhet të jetë fokusi i saj tash e tutje?*

**Gashi:** Ministria e Punëve të Jashtme ka nevojë për një riorganizim më të mirë të diplomacisë, të bazuar në kualitete dhe meritokraci dhe jo në nepotizëm dhe përkatësi partiake. Diplomacia, sikundër edhe ushtria e një shteti, duhet të jenë mbipartiake. Ka shumë diplomatë tashmë të dëshmuar që Ministria e Punëve të Jashtme nuk i angazhon në tërë kapacitetin e tyre dhe shumë të tjerë me kualitete të munguara që marrin detyra dhe përgjegjësi të larta.

**"Epoka e re":** *Z. Gashi, në fillim të muajit korrik pritet vendimi i Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Prisni rekomandim pozitiv? Në përgjithësi, si e shihni ecurinë e Kosovës sa i përket agjendës evropiane?*

**Gashi:** Pres vendim pozitiv. Çdo vendim tjetër do të ishte zhgënjyes. Madje çdo përpjekje e Brukselit apo e kujtdo qoftë për të arsyetuar një vendim negativ do të ma lëkundte besimin në vlerat që promovojnë institucionet e BE-së. Përveç liberalizimit, pjesa tjetër e agjendës evropiane varet shumë nga ne, nga normalizimi i marrëdhënieve me fqinjët, por edhe nga reformat e brendshme për të përafruar funksionimin e shtetit tonë me standardet dhe legjislacionin e BE-së.

# Vetëvendosja dorëzon kallëzimin penal ndaj Qeverisë për rritje të pagave

**Prishtinë, 29 qershor (ER)** - Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka dorëzuar të premten në Prokurorinë Themelore kallëzimin penal për vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritje të pagave të kabinetit qeveritar dhe kryeministrit. Sipas kësaj Lëvizje, ky vendim brutal tregon më së miri katandisjen e Qeverisë Haradinaj që teksa bën çdo ditë skandale, njëkohësisht rrjep edhe buxhetin e varfër të vendit për ta shtuar luksin qeveritar karshi qytetarëve që varfërohen gjithnjë e më shumë.

Anëtarja e kryesisë dhe deputetja Albulena Haxhiu ka thënë se ky është vendim i padrejtë dhe i paligjshëm. "Që nga dhjetori i vitit të kaluar, kur është marrë ky vendim skandaloz, ne e kemi kundërshtuar dhe e kemi cilësuar të paligjshëm sepse e konsiderojmë të jashtëligjshme që Qeveria me anë të një vendimi të tillë t'ia rrisë vetes pagën. Mirëpo, këtë vendim e kemi dërguar në disa institucione të Republikës së Kosovës si Gjykata Kushtetuese, që nxori vendim të padrejtë, por edhe në Agjencinë Kundër Korrupsion, që ka vlerësuar se rritja e pagave përbën konflikt interesi", është shprehur Haxhiu. Po ashtu, ajo ka theksuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës, përveç Kodit Penal, shkel edhe një numër të madh ligjesh, si: Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin për buxhetin e vitit 2018. Për Lëvizjen Vetëvendosje ky vendim mbetet i papranueshëm për faktin se, përpos që shkel ligjin, Qeveria e Kosovës ende nuk ka bërë asnjë hap në drejtim të zhvillimit të vendit, ndërkohë që gjendja sociale është jashtëzakonisht e rëndë.



# SKËNDERBEU PËR NJË COPË SHQIPËRI I LUFTOI TË GJITHË



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Jo vetëm njohuritë që vijnë nga hapësira kohore e 500-vjetorit deri te 550-vjetori i Gjergj Kastriotit Skënderbeut (vitet 1968-2018), për elitën intelektuale, por edhe për njeriun mesatar të kombit tonë, disa gjera që kanë të bëjnë me origjinën, jetën, veprën e vdekjen e Skënderbeut, nuk do të duhej të bëheshin tema debati e ridebati, pasi shkenca e historisë jo vetëm shqiptare i ka konfirmuar e argumentuar disa gjëra shumë mirë. Natyrisht, këtu e kam fjalën për njerëzit që kanë lexuar së paku veprat e katër-pesë autorëve (studiuesve) seriozë të jetës e të veprës së Skënderbeut, qofshin ata autorë shqiptarë apo të huaj. Madje mund të them se cilido që e ka lexuar me vëmendje veprën e Marin Barletit, studimet e Aleks Budës dhe veprën e Kristo Frashërit, pa përfshirë veprat poetike të De Rades e të Naim Frashërit, do të duhej të bindeshin se Skënderbeu është shqiptar e bir shqiptari si nga baba, po ashtu edhe nga nëna, se emrat e prindërve jo vetëm të Skënderbeut në shekullin XV, por edhe emrat e shumicës së shqiptarëve sot, po të shikohen, nuk përcaktojnë kombin shqiptar dhe për pasojë, secilit shqiptar mund t'ia kontestojmë qenien kombëtare. Kështu, mendoj se sorollatja e disa të "diturve" për çdo gjë apo të specifikuar si historianë a politikanë, rreth emrit të nënës së Skënderbeut, Vojsavës s'janë gjë tjetër veçse megalomani për dukje intelektuale. Jo vetëm emrat e banorëve të Pollogut të shekullit XV, por edhe emrat e shqiptarëve të Kosovës dhe të gjithë hapësirës së shqiptarëve të kohës, e cila njihej si Epir, Maqedoni, Arbëri e Dardani (Kosovë), po të shikohen emrat, ata nuk përcaktojnë etninë e as kombin e mëvonshëm. Gjendja në këtë fushë, në fushën e emrave nuk është më e mirë as sot e kësaj dite. Edhe më herët nga autorë antikë, madje edhe Marlin Barleti, shqiptarët i quan me tre emra: epirotas, maqedonas e arbërorë. Shkurt, hapësirat e përmendura denbabaden kanë qenë të banuara me shqiptarë.

Gjithashtu edhe një çështje tjetër, që është bërë e diskutueshme viteve të fundit, është edhe më anakronike, teksa Skënderbeut i mohohet lufta për Atdheun e tij, popullin e tij dhe etninë e tij, duke ia dhënë e lënë luftës çlirimtare të epirotasve (shqiptarëve) vetëm rolin e një kryqëzate, edhe pse lufta zhvillohej në një ambient tjetër kulturor edhe në Evropën e kohës. E gjithë kjo me arsyetimin se në shekullin XV nuk ishin formuar kombet në kuptimin e shekullit XIX! Trajtimi i luftës së Skënderbeut vetëm si kryqëzatë apo përpjekja për një trajtim të tillë jo vetëm që nuk është trajtim shkencor, por është përpjekje për trajtim foshnjor i një lufte të lavdishme të popullit shqiptar. Duhet të thuhet se një përpjekje e tillë nuk ka ndodhur as në shekujt XV-XVI e të mos flasim për shekujt XVIII, XIX e në nëntë dekadat e shekullit XX.

Për këtë pa dyshim ka shumë dëshmi, përveç tjerash, meqenëse vetë shekulli XV nuk njihet në asnjë historiografi si shekull kryqëzate, por si shekull i lulëzimit të Humanizmit dhe të Renesancës, shekull i reformave të mëdha shoqërore. Shikuar vetëm në këtë kënd, përpjekja për t'i dhënë luftës së shqiptarëve të udhëhequr nga Skënderbeu karakter tjetër, tingëllon tepër anakronike, kur qendra që do të duhej së paku ta ndihmonte "kryqëzatën", ajo ishte treguar e kursyer, për të mos thënë shpërfillëse për ta ndihmuar Skënderbeun! Për më tepër, Skënderbeu me ushtarët e tij ka luftuar edhe kundër Republikës së Venedikut, ka ndërhyrë në luftimet e mbretërve në Italinë e Jugut dhe vasalëve serbë të sulltanëve osmanë në Gadishullin Ilirik. Që të gjithë ishin të krishterë. Vetë Evropa e kohës i kishte tejkaluar luftërat e kryqëzatave, pasi një gjë të tillë nuk e bëri as për ta mbrojtur qendrën e dytë të krishterimit - Konstantinopojën (1453). Dhe jo vetëm kaq, por në fund të vitit 1466 (nëntor) e në fillim të vitit 1467 (shkurt), Skënderbeu ishte në Napoli dhe Vatikan (Romë), për të kërkuar ndihmë, por edhe pse Papati kishte grumbulluar para për kryqëzatën, Skënderbeun nuk e ndihmuan pasi Papa "shpenzimet e para do t'i bënte për të siguruar shtëpinë e vet" (K. Frashëri: Skënderbeu - jeta dhe vepra, faqe 448). Sipas L. de Pesaros: "Skënderbeu u nis sot i dëshpëruar, se kardinalit që i dhuroi 200 dukatë", ai (Skënderbeu nën. J. K) i tha me ironi se "tani e tutje duhej t'i bënte luftë Kishës më tepër se sulltanit" (po aty, faqe 450). Kjo politikë e mos interesimit nuk ishte vetëm e Papatit, por ishte edhe e Napolit dhe e Venedikut, edhe pse Skënderbeu nuk ishte shkuar atje për të kërkuar para për salltanet a për të "blerë mercenarë", por për t'i siguruar gjërat më të nevojshme për jetë e luftë, gjëra që shqiptarët i kishin humbur duke e mbrojtur atdheun dhe Evropën nga invazioni osman me jetët dhe gjakun e derdhur të epirotasve (shqiptarëve) të kohës.

Pas atij udhëtimi dëshpërues për bashkatdhetarët dhe Skënderbeun nuk mbeti tjetër rrugë veçse t'i bashkonin forcat arbërore në mbrojtje të atdheut. Kjo bëri, siç thotë Kristo Frashëri, që Lekë Dukagjini të bashkohej me Skënderbeun e t'i bëhej dora e djathtë e tij.

# Policia arreston tre persona të dyshuar për terrorizëm në Kosovë




PRISHTINË, 29 QERSHOR (ER) - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare për Inteligjencë, pas hetimeve disamujore, ka arrestuar tre persona të dyshuar për terrorizëm. "Drejtoria Kundër Terrorizmit, në bashkëpunim edhe me Prokurorinë Speciale të Kosovës, ka ndërmarrë një operacion policor në dy rajone të Kosovës, Prizren dhe Skenderaj, për zbatimin e urdhërkontrolleve të lëshuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë". "Gjatë këtij operacioni, në cilësinë e të dyshuarve, janë shoqëruar në Drejtorinë Kundër Terrorizmit tre persona të dyshuar (R. K., A. A. dhe L. M.), nën dyshimin e bazuar se të njëjtit kanë kryer vepra penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, që ndërlidhen me terrorizëm", thuhet në komunikatën e Policisë së Kosovës. Sipas Policisë, operacioni është zhvilluar në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë edhe me autoritetet gjermane, të cilat kanë zbatuar urdhërarrestin ndërkombëtar të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë ndaj të dyshuarit B. B. Gjatë këtij operacioni Policia e Kosovës bën me dije se në cilësinë e provave materiale janë sekuestruar: një armë automatike AK 47, tre karikatorë të armës AK 47 me 40 fishekë, një pushkë ajrore, një revole colt, një palë dylbi, një veturë me targa të huaja, si dhe disa pajisje elektronike dhe gjësende të tjera, të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale dhe të cilat do të analizohen në vijim.

Me urdhër të prokurorit të rastit ndaj të dyshuarve është shqiptuar masa e ndalimit policor prej 48 orësh.

## Më 28 gusht dhe 1 shtator do të mbahet afati i dytë i provimit të maturës

Prishtinë, 29 qershor (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë vendim për datat e mbajtjes së provimit të Maturës Shtetërore 2018 në afatin e dytë. Sipas këtij vendimi, maturantët e mbetur për afatin e dytë të Maturës do t'i nënshtrohen provimit më 28 gusht 2018 (pjesa e parë) dhe më 1 shtator 2018 (pjesa e dytë). Këtë vendim ministri Bytyqi e ka marrë pas sugjerimeve nga Komisioni Shtetëror i Maturës lidhur me dinamikën e planifikuar të organizimit të Provimit të Maturës Shtetërore.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka njoftuar kabinetin qeveritar për takimin e zhvilluar në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq

# Thaçi, opozitës: Eja jepe dijen dhe patriotizmin në tryezë të bisedimeve

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se faza finale e procesit të dialogut me Serbinë nuk mund të ndalet për shumë arsye. Derisa ka njoftuar kabinetin qeveritar të premten për takimin e fundit në Bruksel me presidentin serb Aleksandar Vuçiq, ai e ka ftuar opozitën të bëhet pjesë e procesit. Thaçi ka thënë se është i gatshëm të raportojë edhe në Kuvendin e Kosovës për procesin e dialogut



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka ftuar edhe një herë përfaqësuesit politikë, përfshirë edhe opozitën, që të marrin pjesë në fazën finale të dialogut me Serbinë. Teksa ka informuar Qeverinë e Kosovës të premten, për takimin e zhvilluar në Bruksel më 24 qershor, me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ai ka treguar gatishmërinë për të raportuar edhe në Kuvendin e Kosovës për këtë proces sa herë të jetë e nevojshme.

Kreu i shtetit ka deklaruar se Kuvendi i Kosovës duhet të jetë i përfshirë në këtë proces në mënyrë të drejtpërdrejtë, derisa koalicioni qeveritar në bashkëpunim me partitë politike parlamentare të opozitës dhe pozitës do të arrijnë t'i përcaktojnë modalitetet e kësaj përfshirje sa më shpejt që të jetë e mundur. "Unë e kam shprehur gatishmërinë të raportoj para Kuvendit sa herë të kërkohet nga kryetari apo ndërkombëtarët. Shpresoj se koalicioni qeveritar, pozitë e opozitë, të arrijë t'i kuptojë modalitetet e përfshirjes në këtë proces. Prandaj, ky proces nuk mund të ndalet për shumë arsye", ka thënë Thaçi.

Presidenti Thaçi ka paralajmëruar se puna e delegacionit të Kosovës në kuadër të këtij dialogu do të jetë transparente, me raportime të rregullta përpara qytetarëve dhe institucioneve. "Për këtë qëllim, edhe përpara nisjes në takimin e parë, e kam bërë të qartë gatishmërinë time për të raportuar përpara Kuvendit të Kosovës sa herë që kërkohet një gjë e tillë", është shprehur ai.

Konsensusi sa më i gjerë politik dhe shoqëror në këtë fazë të dialogut, sipas presidentit Thaçi, jo vetëm që do ta rriste besueshmërinë ndaj këtij procesi, por do ta forconte delegacionin e Kosovës. "Shpresoj se liderët e partive politike ta kuptojnë përgjegjësinë e tyre ndaj institucioneve shtetërore dhe, mbi të gjitha, ndaj qytetarëve të vendit", ka thënë ai. Megjithatë, presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova i ka institucionet e veta shtetërore legjitime dhe demokratike, prandaj askush nuk duhet të pretendojë të vendosë në pikëpyetje legjitimitetin kushtetues dhe ligjor të tyre. "Para nisjes së takimit në Bruksel kam bërë thirrje për bashkim në delegacionin e Kosovës, përfshirë gjithë spektrin politik, ejani dhe bëhuni pjesë e delegacionit të Kosovës dhe jepni dijen dhe patriotizmin tuaj në tryezë të bisedimeve. Ky do të ishte veprimi i duhur, veprimi më racional dhe i guximshëm të cilin e presin qytetarët e Kosovës. Gjithçka tjetër, të gjitha kritikat e pabaza dhe të pamatura, tregojnë vetëm shenja lodhjeje dhe mungesë të përgjegjësisë e guximit", ka thënë presidenti Thaçi para kabinetit qeveritar.

Ai ka treguar edhe për takimet që ka zhvilluar me partnerët ndërkombëtarë para se të takohet me homologun serb. "Kam zhvilluar dy takime pune me përfaqësuesin e ShBA-së përpara mbajtjes së takimit zyrtar. Këto takime të rregullta koordinuese me partnerin tonë kryesor strategjik, ShBA-në, si dhe me shtetet e tjera të fuqishme evropiane të cilat luajnë rol mbështetës për këtë proces, janë tepër të rëndësishme", është shprehur ai.

Duke folur për takimin që ka zhvilluar në Bruksel, presidenti Thaçi ka thënë se e ka bërë të qartë se Kosova është e përcaktuar dhe thellësisht e interesuar për të arritur marrëveshje përfundimtare obliguese dhe ligjore me Serbinë. "Ne kemi bërë të qartë se Kosova ka shteruar kompromiset e veta të cilat janë të konkretizuara në Planin Gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari, respektivisht në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Rrjedhimisht, ne kemi thënë se hapësira për kompromise shtesë nga ana jonë është shumë minimale", është shprehur ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se të dyja palët e përfshira në dialog janë pajtuar për t'i vazhduar përpjekjet e mëtejme për të arritur marrëveshje dhe do të vazhdojnë përpjekjet që të mos lejohet rritje apo përshkallëzim i tensioneve apo provokimeve ndërshtetërore, me qëllimin e vetëm që të ruhen paqja dhe stabiliteti. "Për më tepër, të dy palët jemi krejtësisht të vetëdijshme se e ardhmja evropiane e të dy shteteve varet nga kualiteti i arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Në rastin e Kosovës, marrëveshja përfundimtare dhe njohja eventuale nga Serbia, ka një dimension shumë të gjerë, sepse ne mendojmë se një situatë e tillë krijon një mundësi reale për Kosovën që të bëhet edhe anëtare e OKB-së dhe të njihet nga pesë shtetet e BE-së të cilat ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë", ka shtuar presidenti.

Kosova duhet ta pranojë dialogun si mjetin e vetëm për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, sipas presidentit Thaçi, sepse në rast se ne refuzojmë të bëjmë këtë dialog, atëherë BE-ja dhe partnerët tanë do ta fajësojnë Kosovën për dështimin e tij. "Për më tepër, dështimi eventual i arritjes së marrëveshjes nënkupton paqe të brishtë, marrëdhënie të tensionuara ndërshtetërore të cilat do ta kenë efektin e tyre negativ në rajon dhe më gjerë. Mendoj se të gjitha këto arsye dhe shumë të tjera që nuk po i përmend, na detyrojnë ne të gjithëve, të punojmë me vendosmëri për ta gjetur mënyrën dhe guximin për të arritur marrëveshje përfundimtare", ka deklaruar Thaçi.

Raportimin e presidentit për takimin e fundit që ka pasur në Bruksel me presidentin serb nuk e kanë dëgjuar zyrtarët e Nismës Socialdemokrate. Në këtë takim nuk kanë marrë pjesë zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe as tre ministrat që vijnë nga partia e tij. Nisma edhe më herët ka deklaruar publikisht se nuk pajtohet që presidenti Thaçi ta udhëheqë dialogun me Serbinë.

# Ambasadori Scott: Serbia dhe Kosova do të fitojnë atë për të cilën pajtohen

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Serbia dhe Kosova do të fitojnë vetëm atë për të cilën pajtohen në dialog. Kështu ka thënë të premten ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Beograd, Kyle Scott. I pyetur se cili është maksimumi që mund të fitojë Serbia nga bisedimet për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, Scott ka theksuar se ShBA-ja vetëm i inkurajon palët të bëjnë dialog. "Ne i inkurajojmë të dyja palët të vijnë deri te kompromisi, sepse pa të nuk ka marrëveshje", u ka thënë Scott gazetarëve në Beograd, transmeton Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë". Presidentët e Kosovës dhe të Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq, kanë zhvilluar më 24 qershor rrethin e fundit të bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve. Me këto bisedime, që ndërmjetësohen nga Bashkimi Evropian, synohet të arrihet një marrëveshje ligjërisht e obligueshme për normalizimin e raporteve.



# Oda Amerikane: Mos të lejohet importi i veturave më të vjetra se 10 vjet

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka shprehur shqetësimet e saj në lidhje me iniciativën e ndërmarrë nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik për ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-132 mbi Automjetet për të lejuar importimin e automjeteve më të vjetra se dhjetë vjet. "Duke marrë në konsideratë faktin alarmant të moshës mesatare të automjeteve të regjistruara në Kosovë e cila është më e lartë se 18 vjet, Oda Amerikane u bënë thirrje deputetëve të Kuvendit të mos e aprovojnë ndryshimin e Nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-132 mbi Automjetet i cili parashikon ndalimin e importit të automjeteve të cilat janë më të vjetra se 10 vjet. Oda Amerikane përkrah standardet dhe iniciativat e Komisionit Evropian për t'i përmirësuar emetimet e gazrave të cilat vijnë si rezultat i automjeteve të lehta dhe të rënda. Për më tepër, ne besojmë fuqishëm se ndryshimi i Ligjit nr. 05/L-132 do t'i rriste nivelet e ndotjes të cilat edhe ashtu raportohen më të larta dhe në periudha të caktuara të vitit, si ajo e dimrit të vitit 2017, krijojnë shqetësime për qytetarët. Nuk ka dyshim se një veprim i tillë do të ndikonte negativisht në mjedis dhe do të kishte implikime të mëdha shëndetësore", është thënë në reagimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Sipas kësaj ode, të dhënat e Bashkimit Evropian tregojnë se më shumë se 70 000 vdekje u atribuohen lirimit të nivelit të lartë të dyoksidit të azotit (NO2) nga makinat e vjetra me naftë. "Për shkak të pasojave të mëdha në mjedis dhe në shëndetësi, Gjermania në përgjithësi ka hapur derën për grupet mjedisore për t'i paditur qytetet të cilat nuk i plotësojnë standardet e vendosura nga Bashkimi



Evropian në lidhje me ajrin e pastër; duke rezultuar që Hamburgu të bëhet qyteti i parë gjerman për t'i ndaluar automjetet e vjetra me naftë. Ndërsa edhe kryeqyteti i Francës, Parisi, ka ndaluar automjetet të cilat janë regjistruar para vitit 2000, me qëllim kryesor për ta luftuar ndotjen e ajrit në qytet", theksohet në këtë reagim.

Oda Amerikane beson se joefikasiteti i automjeteve të vjetra i minimizon përfitimet afatshkurtra që mund të gjenerohen nga importi i këtyre veturave. "Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh besimin e saj të fuqishëm se importi i makinave më të vjetra se dhjetë vjet do të ndikojë negativisht në mjedis dhe ka implikime të rënda shëndetësore, e rrjedhimisht u kërkon institucioneve përkatëse të ndërmarrin një qasje më gjithëpërfshirëse duke marrë parasysh ndikimet mjedisore dhe shëndetësore të kësaj politike si dhe praktikat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian", është thënë në reagimin e Odës Amerikane.

# Ndahen paratë për punëtorët e 11 ndërmarrjeve të privatizuara




PRISHTINË, 29 QERSHOR (ER) - Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka vendosur t'i aprovojë raportet e shpërndarjes të fondeve të përkohshme të likuidimit për kreditorët e njëmbëdhjetë ndërmarrjeve shoqërore.

Pas kompletimit të dokumentacionit dhe kontrollimit të llogarive bankare të kreditorëve dhe ish-punëtorëve do të ekzekutohen pagesat në Bankën Qendrore në vlerë prej 501,258.78 eurosh për të gjithë 482 kreditorët e ligjshëm nga këto ndërmarrje shoqërore në likuidim.

Ndërmarrjet për të cilat ka vendosur bordi janë: GJI021 KB "Shillova" me seli në fshatin Shillovë, Komuna e Gjilanit, GJI103 NShT "Mlladost" me seli në Shtërpcë, GJI135 KB "Komogllava" me seli në Komogllavë, Komuna e Ferizajt, GJI153 KB "Luboteni" me seli në Ferizaj, MIT042 NShT "Çyçavica" me seli në Vushtrri, MIT051 "Univerzal" me seli në Leposaviq, PRN058 "Farmed", Prishtinë, PRN061 "Kosova Hidroteknika", Prishtinë, PRN143 KB "Fryti" me seli në Babush të Muhaxherëve, Lipjan, PRN165 KB "Gllogovci" me seli në Drenas dhe PRZ012 NSh "18 Nëntori" me seli në Rahovec. Që nga fillimi procesit të likuidimit deri më tani ky bord ka aprovuar 172 raporte të shpërndarjes së parakohshme/përfundimtare për 172 ndërmarrje shoqërore në likuidim.

Shuma e fondeve të miratuara nga Bordi i AKP-së deri më tani për shpërndarje te kreditorët e ligjshëm që nga fillimi i procesit të likuidimit ka arritur vlerën prej 24,784,057.36 eurosh.

# Faton Thaçi lë pozitën e zëvendësministrit të MTI-së

PRISHTINË, 29 QERSHOR (ER) - Faton Thaçi ka vendosur që nga dita e premte të mos jetë më në postin e zëvendësministrit të Tregtisë dhe Industrisë. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se do të angazhohet në një mision me përgjegjësi të reja. Faton Thaçi ka qenë i emëruar në këtë pozitë nga Nisma Socialdemokrate. "Për nëntë muaj isha i nderuar me përgjegjësi shtetërore në pozitën e zëvendësministrit të MTI-së. Siç e dini, kam publikuar me transparencë aktivitetet, angazhimin dhe përkushtimin tim si pjesë e kabinetit politik të partisë që i takoi në zbatimin e programit të saj Socialdemokrat. Sukseset dhe përpjekjet nuk i konsideroj ndryshe, por vetëm si sukses i përbashkët i ekipit", ka shkruar Thaçi.



# VITIN TJETËR NË... FUND TË PUSIT!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Është titulli i një publikimi të shkrimeve analitike të një politikani me shkollë, përgatitje të shkëlqyera profesionale sikur edhe me një ndjeshmëri të theksuar për këto procese nëpër të cilën po kalon Kosova, por edhe vendet e rajonit që, në një mënyrë apo tjetër, rrugëtimin e Kosovës e përcaktojnë drejt një të ardhmeje të synuar dhe dëshiruar apo i kthen proceset, jo në pikën O, por diku aty te O+.

Në fakt, titulli i këtij publikimi i rrugëtimit të autorit, si dëshmitar aktiv e si vendimmarrës pasiv, të tillë janë sot ata që kanë ndërgjegje njerëzore, kombëtare, morale dhe politike ka qenë: "VITIN TJETËR NË..." kurse unë, që mu besua nga autori të shkarravis diçka, ndjeva se diçka po i mungon këtij titulli i cili hapë mundësi për interpretime të ndryshme dhe çdokush, pas pikave, mund të vazhdojë me atë çka dëshiron, çka i pëlqen, preferencave dhe referencave politike si dhe përmbushje e hakmarrjes ndaj kundërshtarit të cilin e quan kryesisht armik apo ndonjë interpretim tjetër që hynë në sferën e psikologjisë klinike. Duke e njohur personalisht autorin që e konsideroj si Evlia Çelebia apo Marko Polo i përshkrimit të rrugëtimit të proceseve politike e që për dallim prej këtyre dy rrugëtimpërshkruesve, Albinoti e tregon rrugën e qartë drejt cakut të synuar. Dy udhëpërshkruesit e famshëm, në kokën e tyre kishin ngatërrime të orientimit duke mos e pasur të qartë stacionin e fundit e që, në mungesë të sinjalizuesve të komunikacionit apo navigimit të përparuar që e kemi sot, mund të arsyetohen dhe, në këtë kontekst, kanë gjëra të përbashkëta me këta politikanët tanë që, krahasuar me dy të parët, janë rast shumë më i rëndë; përkundër përparimit fantastik shkencor, iu ka humbur rruga në oborr, pa pasur ide se si të dilet nga aty e lërë më ta kenë të qartë një stacion apo cak ku do ta takojnë Godon. Jo Sabri Godon, por Godon e Beketit. Pas leximit të kujdesshëm të këtyre shkrimeve analitike disi fitova përshtypje që edhe autori e ndanë mendimin me mua që, pas pikave ku përfundon titulli, t'i shtohet në fund të pusit, pra VITIN TJETËR NË... FUND TË PUSIT dhe tash e kemi një titull të kompletuar që pasqyron perspektivën e Kosovës si edhe të qytetarëve të saj, përjashtuar këtu politikanët që sillen sikur të kishin ardhur nga një botë tjetër, të shkëputur krejtësisht nga realiteti. Albinoti dhe brezi që i takon, është shpresa, energjia, vullneti, veprimi, mundësia, mendësia dhe kuptimi i ndryshimeve që duhet të ndodhin kurse ne, "Çeta e Profetëve", që dikur ishim nismëtarë dhe bartës të shtyrjes së proceseve, tash, të shndërruar në Çetën e Elefantëve në rrugëtimin drejt vendit ku do t'i lëmë kockat, jemi bërë pengesë e proceseve shkaku se jemi të ngarkuar me hipotekën e ndjenjës së madhështisë për të kaluarën sikur që luftën brenda llojit e kemi shndërruar në art që as Lao Ce nuk do të dinte ta përshkruante në mënyrë më bindëse. Nuk mund të shkojnë drejt të së ardhmes njëjtë sikur ai që bartë mbi supe 100 kg (hipoteka nga e kaluara) sikur ai që i ka supet e lira (ka mendje të hapur dhe nuk vuan nga e kaluara). Ky është dallim midis nesh dhe këtyre që do t'i çojnë proceset më tej. Realisht, çdo gjeneratë që vjen do ta ketë më lehtë se që e kishim ne apo ata para nesh. Dikur duhet të investonim në muskuj, qëndrueshmëri për t'iu përballuar dhunës dhe terrorit gjatë tërë procesit, nga organizimi ilegal, arrestimet, burgjet e deri te lufta e fundit kurse, tani, gjenerata që e ka për mision përfundimin e ndërtimit të shtëpisë, e që ne ua lamë vetëm si ndërtim të vrazhdë, duhet të investojnë në dije. Mungesa e dijes ishte faktori kyç që e pamundësoi përfundimin me sukses të misionit për ndërtim të shtetit dhe bashkim kombëtar nga brezi sakrifikues e që u vërejt sidomos pas përfundimit të luftës. Disi e përfunduam luftën, nuk ditëm ta ndërtojmë paqen. Ta parafrazojë Klauzevicin ashtu siç nuk duhet por se që vërtetë ndodhi në Kosovë: "Procesi i paqes dhe shtetndërtimi bëhet me mjete tjera pas përfundimit të luftës por jo me mjete të luftës...". Po të ishte ndryshe, Albinoti nuk do të kishte fare nevojë ta bëjë këtë libër por do të merrej me analiza tjera siç u takon "doktorëve të politikës" që kujdesen për shëndetin politik në shtetet normale. Në rrethana normale dhe me politikanë që e kanë të përfunduar, së paku shkollën fillore politike, Albinoti nuk do të kishte nevojë të merrej me gjëra të tejkaluara siç ishin raportimet bajate dhe të kota në Këshillin e Sigurimit të OKB-së ku Kosova "përfaqësohej" nga dy aleatë që nuk e kundërshtonin njëri-tjetrin dhe të cilët, në fakt ishin zëri i interesave të Serbisë, kryeadministratori i UNMIK-ut dhe përfaqësuesi i Serbisë. Kosova nuk ishte askund. Shkrimet analitike të përfshira në këtë publikim nisin me 07.09. 2016 dhe përkohësisht përfunduan me 24. 11. 2017, sigurisht për të vazhduar, DERI NË FUND TË PUSIT apo te dalja nga pusi. Pa e prekur fundin e pusit, nuk keni mundësi të dilni nga ai, me kusht se nuk dorëzoheni. Në këtë publikim janë të përmbledhura të gjithë shkaktarët që ndikuan që Kosova të bëhej ashtu si nuk e deshëm dhe si nuk do të duhej të ishte një shtet normal. Mosdija politike dhe analfabetizmi intelektual krijojnë vartësi dhe të çojnë në servilizëm ndaj burokratëve ndërkombëtarë të cilët, falë kësaj dhe përvojave nga vendet e tjera që kanë ngjashmëri me Kosovën por jo edhe krejtësisht të ngjashme (Kosova është rast sui generis edhe në këtë kontekst) e lehtësojnë dhe e rrisin mundësinë e manipulimit me këtë klasë të pashembullt zvarranike duke krijuar situata dhe probleme të cilat Albinoti i përshkruan në publikimin puro politik, VITIN TJETËR NË... pikërisht si një mjek i mirë, e cakton diagnozën apo e identifikon problemin që, në rrethana normale do të ishte ndihmë e madhe dhe lehtësi për ata që marrin vendime. Te ne kemi një situatë tjetër, ata që duhet të marrin vendime për eliminimin apo zvogëlimin e problemeve, janë edhe shkaktarë të këtyre problemeve dhe nuk kanë asnjë interes t'i zgjidhin ato por i (keq) përdorin për ta zgjatur mbijetesën politike.

Roli dyfytyrësh i një pjese të bashkësisë ndërkombëtare është një gjetje e këtyre shkrimeve analitike të cilën e kemi të qartë thuaja të gjithë por se na mungon guximi intelektual ta pranojmë botërisht shkaku se nuk jemi në gjendje ta marrim një përgjegjësi të tillë. Problemi kryesorë që e gërryen sot Kosovën duke ia shkatërruar skeletin shtetërorë për të ardhmen e që autori Maloku e përsëritë thuaja në të gjitha paraqitjet publike apo shkrimet është nepotizmi primitiv sikur edhe klientelizmi politik dhe partiak.

Sa mund dhe a mund të jetë i qëndrueshëm një shtet nëse nuk ka strukturat që garantojnë sigurinë për të gjithë qytetarët, të pavarura, profesionale dhe nën mbikëqyrje institucionale nuk shtrohet fare as si dilemë në këtë publikim sidomos kur analizohet përbërja e AKI-së dhe peripecitë që i ka FSK-ja duke kaluar nëpër vuajtje të Tantalit për t'u shndërruar në ushtri të Kosovës. Nëse një organizëm i gjallë ka probleme të funksionimit të brendshëm, nuk ka ardhmëri apo mund të shndërrohet në barrë për të tjerët, nëse një shtet që është shumë më kompleks se një organizëm, ka aq shumë probleme e që Kosova realisht i ka atëherë jo që nuk mund të flasim për perspektivën si shtet por as për të tashmen, gjithashtu si shtet.

Konstelacioni i fuqisë vendimmarrëse të disa shteteve ndërkombëtare, të rreshtuara në anën tuaj apo kundër e përcaktojnë kualitetin e përbërjes shtetërore dhe funksionimin e saj duke e garantuar qëndrueshmërinë si shtet apo, në të kundërtën duke e bërë shtetin si një qenie të brishtë, me imunitet të dobësuar dhe me rrezik të madh për mbijetesë afatgjatë. Kosova, si vend dhe si shtet nuk dallon aspak nga kurdët dhe Kurdistani përveç faktit se e ka një pavarësi shumë lodhët, me një integritet territorial të kontestuar dhe me një sovranitet të mohuar në një pjesë ku jetojnë serbët e rebeluar apo ka mungesë sovraniteti në marrje të vendimeve që kanë të bëjnë me të ardhmen e saj. Shqiptarët janë të shkapërderdhur në 6 shtete duke e copëtuar korpusin kombëtar që ndikon në destabilizimin afatgjatë të tyre dhe i bënë lehtësisht të manipulueshëm. Thuaja, sipas autorit, në të gjitha shtetet ku jetojnë shqiptarët ka probleme që e kanë një burim e një përmbajtje dhe riciklimi apo mirëmbajtja e këtyre problemeve bëhet lehtësisht i menaxhueshëm duke e mbajtur situatën gjithnjë nën tension apo në gjendje vegjetative, nuk jeni krejtësisht i vdekur por as nuk jepni shenja se do të ringjalleni. Piemonti i të gjithë shqiptarëve ka dështuar në bashkimin e shqiptarëve apo përfaqësimin të interesave të tyre e për bashkim kombëtar është herezi edhe të mendohet dhe e tëra kjo është shndërruar në arenë gladiatorësh midis gjyshit të kombit shqiptar, Sali Berishës dhe babait të këtij kombi, Edvin Ramës. Këta të dy, për ta siguruar mbijetesën dhe ngulitjen afatgjate në skenën politike si dhe përkrahjen ndërkombëtare, luanëve të uritur në arenën e gladiatorëve ua gjuajnë gjymtyrët e shqiptarisë, qoftë nga Çamëria, Kosova, Lugina, Maqedonia apo edhe nga vet Shqipëria. Prandaj edhe i kemi të gjitha këto probleme.

Lojërat dhe ndërskëmcat politike, që ia vendosin njëra-tjetrës partitë politike gjatë formimit të koalicioneve për të qeverisur e që në shqip përkthehet si imoralitet i skajshëm është njëri ndër shkaktarët e instalimit të injorancës, joprofesionalizmit, pandershmërisë e që e legalizon kushtëzimin si mjet për arritjen e qëllimeve politike.

Shtetet e rajonit, me një automatizëm ua njohin nënshtetësinë të gjithë bashkatdhetarëve përveç shqiptarëve që ua mohojnë shqiptarëve këtë të drejtë të ligjshme dhe të natyrshme për shkak të presionit dhe kushtëzimeve nga bashkësia ndërkombëtare. Edhe këtë të drejtë natyrore dhe krejtësisht të ligjshme, njohja e shtetësisë po keqpërdoret për qëllime të përfitimit politik nga spekulantët politikë, si të Kosovës ashtu edhe të Shqipërisë aq më parë që Shqipëria ua ka njohur shtetësinë bijve dhe bijave të ish-udhëheqësve shqiptarë të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë të cilët edhe sot, më shumë e duan Serbinë, se Shqipërinë.

Hallkat e zinxhirit të shkrimeve analitike të publikimit VITIN TJETËR NË... janë të shumta dhe nuk mund të analizohen veç e veç por si një tërësi e pashkëputur dhe logjike që e përcaktojnë gjendjen në të cilën gjendet sot Kosova por edhe vendet tjera ku jetojnë shqiptarët duke ua siguruar një rrugëtim me shumë pikëpyetje dhe me shumë të paqarta e që është një terren i përshtatshëm dhe tokë e premtuar për të gjithë kriminelët dhe keqbërësit, vendorë dhe ndërkombëtarë me të cilët, kundër vullnetit tonë është e mbjellë sot Kosova. Albinot Maloku, duke e përshkruar drejt dhe sinqerisht situatën sikur edhe akterët që ndikojnë në këtë situatë duket se ka hequr dorë nga politika e cila, si e tillë nuk ka vend për Albinotin por se as Albinoti, në këto rrethana dhe në këto kushte në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet kubëz për ta plotësuar mozaikun, kryesisht të kriminalizuar të skenës politike kosovare. Me edukimin familjar që e ka, me ndërtimin intelektual dhe me besimin te njeriu, hë për hë është trup i huaj në këtë organizmin e kalbëzuar politik. Dhe mirë që është. Çka duhet të bëjë në këtë çast Albinoti dhe ata që bashkëmendojnë si ai?! Duhet të shkruajnë dhe vetëm të shkruajnë. Lima nuk e heq ndryshkun e ndërgjegjes e as ndonjë preparat kimik. Vetëm shkrimi e zgjon ndërgjegjen e fjetur dhe e pastron ndryshkun e ndërgjegjes. Nëse bëhet në kohë të caktuar dhe në mënyrë të duhur!

# Elezaj e Dema zotohen për vazhdim të bashkëpunimit



KLINË, 29 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka pritur në takim rektorin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Marjan Dema.

Kryetari Elezaj e ka njoftuar rektorin Demaj rreth rrjedhave të qeverisjes lokale të Komunës së Klinës dhe përpjekjet të cilat është duke i bërë ekzekutivi i Klinës në aspektin e zhvillimit të kësaj komune në shumë segmente të jetës.

Elezaj i ka prezantuar Demës shumë veprimtari që janë kryer në këtë komunë për kohën sa është në krye të qeverisjes komunale, duke u fokusuar kryesisht në disa të arritura në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizime, shëndetësi, arsim etj.

Edhe rektori i UP-së, Marjan Dema, e ka njoftuar kryetarin Elezaj për zhvillimet dhe të arriturat që janë duke u zhvilluar në Universitetin e Prishtinës, me kahet pozitive dhe prioritetet që Universiteti i Prishtinës ka marrë për një arsim edhe më cilësor në ngarendje për t'i synuar trendët e standardizuar të një arsimi bashkëkohor të nivelit evropian.

Kryetari Elezaj dhe rektori Demaj janë zotuar për një bashkëpunim të vazhdueshëm në mes të Komunës së Klinës dhe Universitetit të Prishtinës, sidomos në fushën e arsimit dhe të edukimit.



# Kryetarit të Prizrenit nuk i lejohet hyrja në Serbi

PRIZREN, 29 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë me dije të premten se i është ndaluar hyrja dhe kalimi në Serbi. Ai ka treguar se gjatë këtij udhëtimi ka qenë duke shkuar për vizitë pune në Osijek të Kroacisë.

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) këtë ndalim të kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, e ka vlerësuar se pengesat e qytetarëve dhe zyrtarëve për të lëvizur lirshëm nëpër shtetet e Ballkanit, tregon për një mentalitet të vjetërsuar të autoriteteve të Beogradit e që assesi nuk po mund të kuptohet realiteti i ri në këtë pjesë të Evropës. "Asociacioni i Komunave të Kosovës kërkon nga institucionet qendrore qeveritare të Kosovës reagim të fuqishëm institucional tek autoritetet e Bashkimit Evropian, në veçanti lidhur me dialogun me Serbinë, të paktën, për të vënë në funksion lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe të zyrtarëve të zgjedhur të komunave të Kosovës", është thënë në reagimin e AKK-së.




# 'EC Ma Ndryshe', e shqetësuar me shenjëzimin në Qendrën Historike të Prizrenit

PRIZREN, 29 QERSHOR (ER) - "EC Ma Ndryshe" ka organizuar të premten performancën publike "Shenjëzimi dhe reklamimi kaotik në Qendrën Historike të Prizrenit". Përmes këtij aktiviteti "EC" ka shprehur shqetësimin lidhur me shenjëzimin për trashëgiminë kulturore të patrajtuar nga shteti dhe reklamimin e pakontrolluar që si rezultat kanë sjellë një degradim vizual të Qendrës Historike të Prizrenit. Kësaj performance publike i ka paraprirë një hulumtim, të cilin "EC Ma Ndryshe" e ka bërë për problematikën në fjalë.

Nga ky hulumtim janë identifikuar mbi 200 ndërtesa që kanë tabela dhe reklama që janë në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe vendimin mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit. "Ndërkohë përfitimi i komunës nga taksat për reklama përgjatë kësaj periudhe ka qenë 0 euro. Vendosja e reklamave të partive politike, bizneseve e organizatave kryesisht është bërë pa pëlqim të organeve të trashëgimisë kulturore. Ky hulumtim është marrë specifikisht me identifikimin e fenomenit të degradimit vizual dhe adresimin e përgjegjësive fillimisht institucionale të Qendrës Historike të Prizrenit dhe nuk pretendon t'i denigrojë apo dëmtojë bizneset e veçanta që janë paraqitur përmes reklamave të tyre", është thënë në komunikatën e "EC Ma Ndryshe".

Si mangësi që adresohet përmes kësaj performance është mungesa e standardizimit nga shteti për sinjalistikë rrugore, shenjëzim e tabela interpretuese për lokalitete të trashëgimisë. "Kosova në përgjithësi në krahasim me shtetet e rajonit është shumë prapa sa i përket rregullimit të kësaj fushe, andaj kjo është edhe një thirrje tjetër që i bëhet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Infrastrukturës të përfundojnë sa më parë përcaktimin e legjislacionit për standardizimin e sinjalistikës rrugore për lokalitetet e trashëgimisë kulturore dhe udhëzuesin për komunat e Kosovës ku do të përcaktohej formati teknik i shenjave për sinjalistikë rrugore dhe atë këmbësorike", është thënë në komunikatën e "EC Ma Ndryshe".

Sipas "EC Ma Ndryshe", Komuna e Prizrenit udhëzohet ta bëjë përditësimin dhe përmirësimin e vendimit mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit duke i shtuar disa nene përkatëse dhe duke qartësuar disa të tjera.

# Latifi: Krijimi i zonës ekonomike në Rahovec, hap i rëndësishëm për ekonominë

RAHOVEC, 29 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur të premten konferencë për media pas marrjes së vendimit për aprovimin e kërkesës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për krijimin e zonës ekonomike, zonë kjo që do të krijohet mbi fshatin Opterushë.

Lidhur me këtë vendim për krijimin e zonës ekonomike, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se ky vendim është ndër vendimet më të rëndësishme për perspektivën ekonomike të kësaj komune. Ai ka thënë se në këtë mënyrë po përmbushet një kërkesë e kamotshme e bizneseve të Rahovecit për një hapësirë të lirë ku do të zhvillohen veprimtari të ndryshme ekonomike. "Komuna e Rahovecit, si zonë e rëndësishme agrare, është një nga zonat që sjellin përfitime financiare për banorët e zonës dhe për buxhetin e Republikës së Kosovës, prandaj konsiderojmë se krijimi i një zone të lirë ekonomike është hap i rëndësishëm për ekonominë e vendit tonë në përgjithësi. Investimet në këtë zonë agroindustriale janë të një rëndësie të veçantë, prandaj i bëjmë thirrje Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, edhe ministrive të tjera që kanë synim përmirësimin e gjendjes ekonomike e sociale në vend, që të bashkëpunojnë me Komunën e Rahovecit për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme në këtë Zonë Ekonomike dhe për ofrimin e hapësirave për bizneset e Komunës së Rahovecit e më gjerë", ka thënë Latifi.

Ai ka shtuar se finalizimi i një synimi 17-vjeçar përbën arritje të madhe për qytetarët e Komunës së Rahovecit. Latifi ka thënë se Komuna e Rahovecit në afat të shkurtër kohor do të hartojë planin e veprimit dhe do t'i zhvillojë procedurat e nevojshme në mënyrë që zona ekonomike të jetë e qasshme për bizneset e interesuara.



# Më shumë hise në 'kuletën' e NATO-s



Shkruan: Agron HOTI

Dinamikat e zhvillimeve në fushën e sigurisë globale janë shtuar aq shumë pas rënies së komunizmit saqë rendi ri ndërkombëtar është sfiduar në shumë dimensione. Nuk ka pjesë të botës që s'është prekur nga sfidat postkomuniste të sigurisë. E rendi i ri ndërkombëtar është dashur të formësohet mbi këto premisa dhe kjo jo gjithmonë ka qenë e realizueshme.

Pengesat kryesore që sfidojnë rendin e ri ndërkombëtar janë pikërisht ridimensionimet dhe riorientimet e shteteve dhe mekanizmat e ndryshëm ndërkombëtarë varësisht prej trendëve zhvillimorë dhe interesave në ardhje.

Do të ishte e paparamendueshme po të thuhej në vitet e '60-ta dhe '70-ta që Bashkimi Sovjetik pas vitit 1990 do të shkatërrohej dhe se Rusia, përpos ngeljes fuqi rajonale, nuk do të mund ta trashëgonte epitetin e superfuqisë që kishte Bashkimi Sovjetik. Gjithsesi që kryetari Putin ia kishte dalë ta nxjerrë Rusinë nga kolapsi ekonomik i vitit 1991, kolaps ky i akumuluar ndër vite dhe dobësoi deri në limit pozicionin kundërshtues rus ndaj bashkimit e Gjermanive. Tashmë Putini ia ka dalë që përmes taktikave të tij mashtruese dhe shantazhuese të vë në binarë shtete të ndryshme duke ushtruar presion të caktuar. Taktikat e përdorura kanë të bëjnë me detyrimet e ndryshme ekonomike deri te presioni diplomatik, madje edhe detyrimet përmes mjeteve armiqësore, përfshirë shfrytëzimin e popullsive pro ruse në ish shtetet sovjetike.

Gjithsesi që do të ishte po aq e paparamendueshme në vitet '60-ta apo '80-ta të thuhej që Kina pas vitit 2000 do të bëhej fuqia e dytë ekonomike në glob pas ShBA-së, e ndjekur ngushtë nga India e cila deri në vitin 2030 pritet ta tejkalojë Kinën sipas gazetës "Economist". Ndërkohë që Kina sot përpos rritjes së shpenzimeve ushtarake dhe rritjes së presionit përreth saj, ka projeksione ekonomike anë e kënd globit duke sfiduar kështu interesat e ShBA-së dhe NATO-s në përgjithësi.

Do të ishte po ashtu e paparashikueshme që në fillim të viteve të '90-ta, pra në vlugun e integrimit evropian, projekti i Bashkimit Evropian ende pa u kompletuar të futej në krizë aq të thellë sa të braktisej nga Britania e Madhe. Të gjitha këto lëkundje kërkonin përgjigje nga rendi i ri ndërkombëtar dhe kjo ishte më e vështirë të arrihej se sa ç'duket.

Me zhvillimin ekonomik të globit gjithandej, nevoja për qasje në resurse është rritur si kurrë më parë. Po ashtu është rritur edhe gara e eksporteve sa shtetet nuk lënë gurë pa lëvizur për të siguruar tregje të reja. Këto zhvillime assesi nuk do të mund të bëhen pa një siguri globale që garanton lëvizje stabile të njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve.

E siguria globale është pothuaj e pamundshme që të garantohet në çdo cep të globit. Si rezultat i kësaj shtete të ndryshme kanë filluar rritjen e shpenzimeve ushtarake (shih Lindjen e Mesme, Azinë Jugore, Juglindore dhe Verilindore) pa e pasur shumë të qartë se deri ku do të mund të shpie kjo garë e rrezikshme dhe deri në ç'masë mund ta çrregullojë rendin e ri ndërkombëtar.

Në përgjigje të kësaj gjurolltie globale Strategjia Kombëtare e Sigurisë së ShBA-së për vitin 2018 thotë që "ne (amerikanët) jemi duke u përballur me një çrregullim global në rritje, karakterizuar me rënien e rendit ndërkombëtar që bazohej në rregulla afatgjata, që po krijon një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks dhe të paqëndrueshëm se sa që kemi përjetuar në historinë më të fundit".

Duke u bërë më specifike kjo strategji flet konkretisht për sfiduesit e rendit ndërkombëtar duke thënë që "Kina është një konkurrent strategjik që po përdor ekonominë grabitqare për të frikësuar fqinjët përderisa po militarizon zona në Detin e Kinës Jugore". Ndërsa për Rusinë thotë që "ka dhunuar kufijtë e kombeve fqinje dhe ndjek fuqinë e vetos në vendime ekonomike, diplomatike dhe sigurisë për fqinjët e saj". E kjo fuqia e vetos ruse përbën problem të madh edhe për anëtarësimin e Kosovës në Kombe të Bashkuara.

Në përputhje me këto zhvillime, NATO dhe shtetet anëtare të saj kanë filluar ripozicionimin e tyre në aspektin e sigurisë globale. Sigurisht që kjo nuk është duke kaluar pa tension të brendshëm brenda anëtarëve të NATO-s. E tensionet kanë filluar të rriten me ardhjen në pushtet të kryetarit Trump, i cili përmes politikave të tij të rishqyrtimit të gjithçkaje në të mirë të ShBA-së, ka filluar t'i shqetësojë aleatët. E shqetësimet janë ngritur sidomos në Gjermani dhe Japoni, si dy nga ekonomitë më të forta në botë pas ShBA-së dhe Kinës.

Sipas artikullit të Stefan Theil të publikuar në "Foreign Affairs" thuhet se "më shumë se çdo vend tjetër i madh evropian, Gjermania e sotme demokratike dhe prosperuese është produkt i angazhimit amerikan në Evropë" dhe se "pa mbështetjen e vazhdueshme amerikane, rendi botëror liberal që ka gjeneruar prosperitetin gjerman do të shkërmoqej".

Situata nuk është më ndryshe as me Japoninë, e cila nga amerikanët po ashtu konsiderohet pak a shumë si produkt amerikan në Azinë Verilindore. Pra, sipas amerikanëve Gjermania dhe Japonia përfitojnë më së shumti nga rendi liberal ndërkombëtar e investojnë shumë pak mjete ushtarake për ta mirëmbajtur atë.

Ndryshimi që ka sjellë kryetari Trump në politikat e sigurisë së NATO-s është që Gjermania dhe të gjitha anëtaret tjera duhet të rrisin shpenzimet ushtarake nga 1.2 % të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) në 2 % deri në vitin 2024. Pas referendumit për dalje nga BE nga Britanisë së Madhe dhe pas ardhjes së kryetarit Trump në pushtet me moton "Amerika së Pari", elita politike gjermane e pa menjëherë të nevojshme që përfundimisht t'i përvjelë mëngët përballë cenueshmërisë ekonomike të Gjermanisë, pra varësisë së këtij shteti nga eksportet që përbëjnë mbi 50 % të GDP-së.

Në këtë drejtim diplomacia gjermane ndezi dritat e thellimit të bashkëpunimit me çdo akter global me qëllim të rritjes së kontributit të saj në sigurinë globale dhe me këtë edhe uljen e cenueshmërisë së eksporteve të saj anë e kënd globit. Gjithashtu, premtimet e kancelares Merkel janë që Gjermania duhet të rrisë kontributin e vet në të mirë të paqes në botë, që me fjalë tjera i bie të rrisë shpenzimet ushtarake.

Ndërkohë, që situata nuk është më ndryshe as me Japoninë, e cila gjendet në një rajon të paqëndrueshëm në aspektin e sigurisë duke marrë parasysh këtu kontestet me Kinën dhe Korenë Jugore për ishujt detarë në Detin e Kinës Jugore, kërcënimet direkte të Koresë Veriore me lansimet e raketave bërthamore pranë brigjeve japoneze.

Ardhja e kryetarit Trump në pushtet kishte dridhur elitat japoneze, pikërisht për shkak të faktit që sipas Trumpit Japonia duhet të rrisë shpenzimet ushtarake në refleksion të rritjes së kontributit japonez në sigurinë rajonale dhe mbështetjes së forcave amerikane në territorin japonez, përderisa ShBA-ja mbetet e zotuar për zbatimin e nenit 5 të Traktatit të Sigurisë Japoni-ShBA që në rast të ndonjë sulmi ndaj Japonisë reagimi amerikan të mos mungojë.

Gjithsesi, që një riarmatim i Japonisë nuk do të përpihet lehtë as nga Kina e as nga Koreja Veriore e ajo Jugore, kjo për shkak të së kaluarës historike dhe kapaciteteve të theksuara japoneze për të ndërtuar, ndër të tjera, edhe armë bërthamore dhe flotë detare dërrmuese. Në anën tjetër, riarmatimi i Japonisë është në kundërshtim me parimet japoneze të ndjekura që nga Lufta e Dytë Botërore që Japonia duhet të jetë "komb që do paqen" siç e ka reflektuar edhe në Strategjinë e saj Kombëtare të Sigurisë.

Ndërkohë që Gjermania dhe Japonia, si dy vende që varen shumë prej eksportit, do ta kenë tepër të vështirë reduktimin e eksporteve në favor të rritjes së shpenzimeve ushtarake, kjo sepse një ndryshim i tillë mund të rrisë papunësinë në të dyja vendet dhe mund të rrisë pakënaqësitë sociale gjithandej. Vështirësia konsiston edhe në faktin se qytetarët e Gjermanisë dhe Japonisë janë kundër çdo riarmatimi si rezultat i së kaluarës së hidhur. Nuk duhet harruar që çdo riarmatim i Gjermanisë dhe Japonisë sigurisht që do të rrisë shqetësimet e shteteve fqinje si rezultat i së kaluarës agresive të këtyre vendeve.

Pra, meqë mjedisi i sigurisë në glob është duke u bërë gjithnjë e më i paqëndrueshëm, secili shtet është duke u munduar të identifikojë interesat kombëtare në perspektivë afatmesme dhe afatgjatë, përcaktimin e kursit që duhet ndjekur karshi rendit ndërkombëtar dhe të krijojnë politika kombëtare të sigurisë dhe masa me qëllim të vazhdimit të zhvillimit të një rendi ndërkombëtar sa më prosperoz dhe paqësor.

Shtetet anëtare të BE-së që janë anëtare të NATO-s kanë filluar të lëvizin në drejtim të propozimeve të kryetarit Trump për rritje të angazhimit dhe shpenzimeve ushtarake. Të gjithë këta hapa janë duke u ndërmarrë si përgjigje ndaj kërcënimeve dhe ndërhyrjeve ruse duke filluar nga vendet baltike dhe pellgun e Detit të Zi. Vetë fakti i angazhimit të ushtrisë gjermane në vendet e Baltikut tregon për fillimin e rritjes së prezencës ushtarake gjermane nëpër zona të nxehta të Evropës.

Vazhdimi i prezencës së NATO-s në Kosovë është përgjigje ndaj këtyre zhvillimeve. Prezenca e qendrës 'humanitare' ruse në Nish të Serbisë, pashmangshëm kërkon vazhdim të prezencës së NATO-s në Kosovë. Edhe mbështetja e NATO-s që Kosova gradualisht të lëvizë drejt forcave të armatosura është në funksion të zvogëlimit të ndikimit rus në rajon.

Se sa do ia dalin vendet e BE-së pas Brexit-it të bashkërendojnë politikat e sigurisë së tyre në refleksion të projeksioneve të NATO-s kjo mbetet të shihet. Shikuar BE-në sot, nuk të jep shumë për të shpresuar që do të arrijë ndonjë konsensus për të lëvizur drejt një mbrojtjeje të përbashkët evropiane edhe pse kjo nuk mundësi nuk mund të përjashtohet tërësisht.

Ndërkohë që ShBA-ja do ta vazhdojë politikën e saj të reflektuar në Strategjinë Kombëtare për Siguri që të jetë "e përgatitur për ta mbrojtur vendin, që të mbetet fuqia kryesore ushtarake në botë, që të sigurohet se balanca e fuqisë të mbetet në favor të saj (ShBA-së) dhe të avancohet një rend ndërkombëtar që është më së shumti i favorshëm për sigurinë dhe prosperitetin e ShBA-së".

Duke parë zhvillimet në glob, shteteve anëtare të NATO-s nuk u mbetet tjetër rrugë përpos rritjes së kontributeve të tyre financiare në 'kuletën' e NATO-s. Sa më herët që lëvizet në këtë drejtim aq më mirë do të jetë për sigurinë e Evropës në radhë të parë dhe interesave të NATO-s në tërësinë e tyre. Sa më e madhe 'kuleta', aq më e madhe siguria.

## Agjencia për Migrim e OKB-së e refuzon kandidatin e Trumpit

NJU JORK, 29 QERSHOR - Agjencia për Migrim e Kombeve të Bashkuara e refuzoi kandidatin për udhëheqës, të emëruar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump. Ky post është mbajtur nga amerikanët qysh në vitin 1951. Diplomatët që morën pjesë në tri raunde votimi në Organizatën Ndërkombëtare për Migrim u thanë mediave se Ken Isaacs, nga Organizata Humanitare e Krishterë Samaritan's Purse, u eliminua dhe se konkursi vazhdon.

Gara tani zhvillohet në mes të Antonio Vitorinos, ish-komisionar i Bashkimit Evropian nga Portugalia dhe Laura Thompsonit nga Kosta Rika.

# Liderët e BE-së arrijnë marrëveshje për migrantët

BRUKSEL, 29 QERSHOR - Liderët e Bashkimit Evropian (BE) kanë arritur një marrëveshje për migrimin, pas gati 10 orësh negociata në një samit në Bruksel.

Italia, pika hyrëse për mijëra migrantë, kryesisht nga Afrika, ka kërcënuar me vënie të vetos ndaj të gjitha përfundimeve të grupit, nëse nuk i ofrohet ndihmë për këtë çështje. Bisedimet kanë vazhduar deri në orët e para të së premtes, para se të arrihej një kompromis. Liderët kanë thënë se qendrat e reja për migrantët duhet të krijohen në shtetet e BE-së, në baza vullnetare. Këto qendra do të verifikonin se cilët migrantë janë refugjatë dhe kush është "migrant i paligjshëm, që duhet të kthehet", thuhet në dokument.

Në një komunikatë të përbashkët përmendet kufizimi i lëvizjeve të azilkërkuesve brenda vendeve të BE-së. "Pas këtij samiti evropian, Evropa është më e përgjegjshme dhe ofron më shumë solidaritet", ka thënë kryeministri italian Giuseppe Conte, duke shtuar se sot Italia nuk është më e vetme.

Kancelarja gjermane Angela Merkel, e cila ka ardhur në samit me nevojën e arritjes së një marrëveshjeje për shkak të krizës politike në vendin e saj, ka deklaruar se BE-ja duhet "të bëjë ende shumë punë për t'i tejkaluar pikëpamjet e ndryshme". Aktualisht blloku është thellësisht i ndarë për çështjen e migrimit, pasi disa shtete evropiane janë duke kundërshtuar skemën e BE-së për rivendosjen e 160 000 refugjatëve nga kampet e stërmbushura në Greqi dhe Itali.



# May: BE-ja rrezikon sigurinë e qytetarëve



LONDËR, 29 QERSHOR - Qytetarët mund të jenë më të pak të sigurt nëse Mbretëria e Bashkuar largohet nga marrëveshjet kyçe policore, pas Brexit-it, ka thënë kryeministrja britanike Theresa May.

Britania e Madhe ka thënë se Bashkimi Evropian është duke bllokuar marrëveshjet për ndjekje të terroristëve dhe ndarje të informacionit pas marsit të vitit 2019.

Ndërsa BE-ja ka deklaruar se kur Britania e Madhe të bëhet "palë e tretë", nuk mund të ketë qasje në iniciativat policore.

Kryeministrja britanike u ka bërë thirrje liderëve të "konsiderojnë se çfarë është në interesin më të mirë të qytetarëve tanë dhe tuaj". Duke folur në samitin që po mbahet në Bruksel, May ka thënë se largimi i Britanisë nga skema e zbatimit të ligjit do të nënkuptonte se do të zvogëlohej aftësia për ta luftuar terrorizmin. "Ne nuk do të kishim më mundësi për të ndarë alarmin në kohë të saktë për personat që janë në kërkim, duke përfshirë kriminelët seriozë. Kjo nuk është ajo që dua unë dhe besoj se as ju nuk dëshironi një gjë të tillë", është shprehur liderja britanike.

Sipas saj, liderët evropianë duhet të bartin porosinë te negociatorët e tyre për t'i lejuar Mbretërisë së Bashkuar qasje në profilet e ADN-së, sistemin e informatave për Zonën Shengen, databazë për alarme në kohë të saktë, si dhe mundësi për shfrytëzim të informatave në Sistemin Informativ të të Drejtave Penale Evropiane.

# Stoltenbergu: Maqedonia në NATO, pas zbatimit të marrëveshjes për emrin

Bruksel, 29 qershor - Maqedonia do të bëhet anëtare e NATO-s pas zbatimit të marrëveshjes për emrin me Greqinë. Kështu ka deklaruar sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, pas takimit në Bruksel me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev.

Kreu i Aleancës beson që në samitin e NATO-s më 11 dhe 12 korrik, liderët e vendeve anëtare do t'i bëjnë ftesë Maqedonisë për nisjen e bisedimeve për anëtarësim. "Marrëveshja për emrin paraqet shembull për të tjerët për konsolidimin e paqes dhe stabilitetit. Pres që në samitin pas dy javësh, të ftoheni në negociata për anëtarësim, ndërsa pas finalizimit të marrëveshjes të bëheni anëtare të NATO-s. Pa e finalizuar marrëveshjen nuk mund ta bëni këtë. Dera e NATO-s është e hapur, mos e humbni këtë mundësi", ka deklaruar Stoltenbergu.

Ndërsa kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, u ka bërë thirrje qytetarëve t'i japin mbështetje "të ardhmes evropiane të Maqedonisë" ndërsa ka



folur për punën që ka bërë Qeveria për zgjidhjen e kontesteve me shtetet fqinje. "Marrëveshja me Greqinë hapi procesin që më në fund të bëhemi pjesë e NATO-s. Vetëm brenda një viti Maqedonia ka arritur atë që askush nuk mund të kishte parashikuar. Vullneti i fortë për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet na solli lajme shumë të mira. Tani kemi për çfarë të bashkohemi. Le t'i themi 'po të ardhmes sonë'", ka deklaruar Zaev, duke shprehur bindjen se Maqedonia do të bëhet anëtarja e 30 e NATO-s.

## BE-ja vazhdon edhe për gjashtë muaj sanksionet kundër Rusisë

BRUKSEL, 29 QERSHOR - Liderët e Bashkimit Evropian janë pajtuar për t'i vazhduar sanksionet ekonomike të bllokut ndaj Rusisë, për ta ndëshkuar këtë të fundit për agresionin e saj në Ukrainë. Drita e gjelbër për sanksione për gjashtë muajt e ardhshëm është dhënë në samitin e BE-së, që është mbajtur të premten në Bruksel.

Presidenti francez Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane Angela Merkel u kanë bërë thirrje liderëve të pajtohen për sanksionet, pasi kanë dhënë detaje sa është zbatuar marrëveshja e Minskut.

Pavarësisht prej përpjekjeve për të arritur një armëpushim afatgjatë në Ukrainë, pakti i arritur në kryeqytetin bjellorus nuk është zbatuar asnjëherë plotësisht nga të dy palët. Sanksionet, të cilat kryesisht godasin sektorin bankar dhe atë të energjisë në Rusi, janë vënë fillimisht në verën e vitit 2014, pasi Rusia ka aneksuar Krimenë dhe ka mbështetur separatistët në konfliktin në lindje të Ukrainës.

Më shumë se 10 300 persona janë vrarë në konflikt derisa liderët e BE-së kanë thënë se sanksionet nuk do të hiqen derisa Rusia dhe palët e tjera në konflikt të arrijnë



përparim siç është paraparë në marrëveshjen e Minskut.

Nga viti 2014 sanksionet janë zgjatur çdo gjashtë muaj.

# Dhjetë vende në Itali ku deti është i mrekullueshëm

Nga veriu në jug të çizmes, ja disa bizhuteri të natyrës, midis ujërave të bruzës, shkëmbinjve madhështorë dhe plazheve të ëndrrave

Të gjithë e dimë: për të gjetur një det të mrekullueshëm, nuk duhet të shkosh në anën tjetër të botës. Italia ofron vende me bukuri të mrekullueshme në mes të natyrës së pashkatërruar, plazheve të mrekullueshme dhe detit kristal: këtu janë dhjetë, të gjithë për t'u vizituar dhe për të mbushur sytë.


1


2


3

**1.BERGEGI - PONENTE LIGURE** - Ishulli, bregu shkëmbor përballë detit, shpella e detit kanë qenë pjesë e Rezervës Natyrore Rajonale që nga viti 1985 dhe një zonë detare e mbrojtur. Bregdeti mbizotërues dhe deti i mrekullueshëm janë bukuri e mahnitshme.

**2.FIASCHERINO - SPEZIA** - Ky fshat midis Lericit dhe Tellaros ofron disa nga plazhet e pakta në këtë shtrirje të bregdetit shkëmbor dhe piktoresk. Peizazhi është i bukur dhe deti është i qartë.

**3.ISHULLI I ZAMBAKËVE - TOSKANA** - Campese është plazhi më i madh në ishull, i strehuar nga era dhe ideal për ata që duan të marrin diell dhe të ecin. Ajo është e vendosur në pjesën veriperëndimore të ishullit dhe mund të arrihet lehtë me transport publik (makinat private nuk mund të qarkullojnë në ishull). Dominohet nga një kullë e lashtë, e restauruar dhe transformuar sot në një vendbanim privat.


9


10


4

**4.PLAZHI I DY MOTRAVE - RIVIERA E CONERO** - MARCHE - Është simboli i këtij bregdeti, ende i egër dhe i papërpunuar. Emri i tij u detyrohet dy shkëmbinjve binjakë që mbyllin hyrjen. Është plazhi i parë që mblidhet në anën jugore të malit Conero dhe mund të arrihet vetëm nga deti.

**5.ISHULLI I BUKUR - TAORMINA - SIÇILI** - Ishulli i bukur lidhet me tokën nga një isthmë e shkurtër që shpesh, kur ngrihet vala, zhytet tërësisht. Plazhi i bukur me guralecë dhe zhavorr është pjesë e një Rezervati Natyror të themeluar në vitin 1998.

**6.PLAZHI I LEPUJVE - LAMPEDUZA** - Është një nga plazhet më të famshme të Mesdheut dhe konsiderohet ndër më të bukurit në botë. Është gjithashtu një nga vendet e fjetjes së breshkave të Detit Caretta-Caretta.

**7.SAN NICOLA ARCELLA - PLAZHI I ARCO MAGNO - CALABRIA** - Jemi në Rivierën e Cedrit, në provincën e Kozencës. Plazhi është një gjuhë e vogël me rërë të imët dhe guralecë me një lagunë në formë të lezetshme. Mund të arrihet në këmbë nga plazhi i afërt Praja a Mare.

**8.PLAZHI PINK - ISHULLI I BUDELLI - SARDENJË** - Është një plazh me rërë shumë të bukur, për fat të keq në vitet e fundit pushtuar nga turistët, rëra e të cilit merr ngjyrë rozë për shkak të pranisë së koraleve dhe shkëmbinjve rozë që e rrethojnë. Është një nga më të bukurat dhe më të famshmet e Sardenjës, sot e mbrojtur dhe e kufizuar.

**9.TORRE DELL'ORSO - PUGLIA** - Është pjesë e Marinës Melendugno, në brigjet e Adriatikut të Salentos. Gjiri shtrihet në formën e gjysmës së hënës për gati një kilometër dhe kufizohet nga dy shkëmbinj: nga një prej tyre mund të admironi faraglioni të famshëm të quajtur 'Le Due Sorelle'.

**10.BAIA DELLE ZAGARE - VIESTE - PUGLIA** - Simboli i Gargano, është një nga plazhet më të bukura të Pulias. Ka rërë të bardhë dhe të butë të përzier me guralecë: ajo mund të arrihet në këmbë përgjatë një rruge midis bajameve, pishave dhe ullinjve. Nga plazhi ju mund të admironi shkëmbinjtë e bardhë gëlqerorë, të quajtur 'Arco di Diomede' dhe 'Le Forbici'. *(gazeta-Shqip.com)*


5


6


7


8

E jashtëzakonshme

## Rruga më e rrezikshme në botë pritet të bëhet atraksion turistik



Një rrugë malore mes provincave Trabzon dhe Bayburt në verilindje të Turqisë, e cila është cilësuar si "rruga më e rrezikshme në botë", do të jetë atraksion turistik për të apasionuarit pas natyrës. Kjo rrugë ka 13 kthesa të mprehta dhe thuhet të jetë më e rrezikshme se e ashtuquajtura "rruga e vdekjes" në Bolivi. Rruga në fjalë është ndërtuar gjatë pushtimit rus në vitin 1914.

FOTO E DITES




Oficerët e patrullës së autostradës në Kaliforni përpiqen ta kapin një person i cili shihet mbi tabelën e autostradës. /AP/

E rrallë

## Mahnitëse, artisti dhjetëvjeçar që krijon piktura super reale



Kareem Waris Olamilekan është një dhjetëvjeçar nigerian. Ai është një artist me plane të mëdha, i cili frymëzohet nga artistët Michelangelo dhe Arinze Stanley Egbengëu. Për "BBC", ai ka treguar se ka nisur të vizatojë në moshën gjashtëvjeçare. "Unë vizatoj miqtë e mi, personazhet e kartonëve, ilustrimet nga librat me figura, apo gazetat", ka thënë Olamilekan.

## BARSOLETA E DITËS



**Biseda ndërmjet dy vogëlusheve:**
**- Lodra ime është më e bukur se e jotja.**
**- Jo, nuk është.**
**- Vetura e familjes sime është më e bukur se e juaja.**
**- Jo, nuk është.**
**- Mamaja ime është më e bukur se e jotja.**
**- Kështu më thotë edhe babai im...**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,




Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo




**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)




Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**




**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot do të keni një ftesë për një ngjarje të rëndësishme. Shikoni në detaje çfarë do të vishni sepse do të ketë rëndësi paraqitja e jashtme.



**DEMI**
Ndiheni mirë në ambientet e shtëpisë sot dhe nuk doni të dilni as për punë e as për ndonjë gjë tjetër. Çuditërisht partneri do të qëndrojë t'ju bëjë shoqëri.



**BINJAKËT**
Keni dëshirë për udhëtime dhe për ndjesi të reja, por miqtë tuaj do t'ju lënë vetëm në këtë ide të çmendur. Nuk do të jetë asnjë që do t'ju shoqërojë.



**GAFORRJA**
Frika dhe dëshira të fshehta do të turbullojnë sot mendjen tuaj. Një flirt në punë po bëhet më i rrezikshëm sesa që e mendonit.



**LUANI**
Sot do t'i shoqëroni fëmijët në çdo gjë që ata kërkojnë. Jeni tipa të rezervuar, por sot do të tregoni se vetëm të vegjlit mund t'jua rrëmbejnë zemrën.



**VIRGJËRESHA**
Ndiheni keq sot që puna juaj zë atë kohë të vyer që mund të kalonit me dashurinë e zemrës. Por, disa impenjime nuk mund t'i anashkaloni dot.



**PESHORJA**
Disa aspekte jo të këndshme të karakterit tuaj sot do të dalin në dritë jo për fajin tuaj, por sepse persona aspak miqësorë po ju shtyjnë të kundërveproni.



**AKREPI**
Jeni të shqetësuar t'i ulni gjakrat brenda mureve të shtëpisë sot. Ju jeni amortizatori i vetëm i situatave të ndezura dhe konfliktuale.



**SHIGJETARI**
Meqenëse me financat jeni në rregull gjatë këtyre ditëve, e vetmja gjë që ju shqetëson është komunikimi dhe marrëdhënia me miqtë.



**BRICJAPI**
Sot çdo gjë që ju rrethon në ditën tuaj ka të bëjë me artin. Kreative ose jo do të dini t'i shijoni situatat dhe personat që ju sjell dita.



**UJORI**
Nuk do të keni limite sot si në gjërat e mira ashtu edhe në ato të këqijat që ju rezervon dita. Një kakofoni e madhe ndjenjash s'po ju lë të qetë.



**PESHQIT**
Jeni paksa të plogësht sot, por jeni shumë të dashur me personat që ju rrethojnë. Ndieni nevojën e një përqafimi herë pas here.

# Drake e pranon se ka një fëmijë



Përmes albumit të ri "Scorpion", Drake ka konfirmuar se është prind. Thashethemet filluan para një viti, ku thuhej se ai e la shtatzënë ish-yllin e pornografisë, Sophie Brussaux, dhe tani përfundimisht po konfirmon se është babai i foshnjës së saj. Në këngën "Emotionless", Drake thotë: "Nuk po e fshihja fëmijën tim nga bota, po e fshihja botën nga fëmija im".

# Heather Locklear shtrohet në spital për mbidozë



Nuk kanë të përfunduar telashet për aktoren e famshme të serialit "Melrose Place". Heather Locklear është shtruar në spital disa orë pasi u lirua nga burgu. Aktorja e famshme u arrestua pasi sulmoi një polic dhe një punonjës të shërbimit mjekësor në shtëpinë e saj në jug të Kalifornisë. Por, mjekët u thirrën në shtëpinë e saj pasi Locklear dyshohet se kishte marrë mbidozë. Raportohet se aktorja u transportua me ambulancë për në spital.




# Julia Roberts u bashkohet rrjeteve sociale, imazhi i parë merr mijëra pëlqime

Julia Roberts është një ndër aktoret më të famshme në rrafshin ndërkombëtar. Ajo deri më tani shumë pak i ka shfrytëzuar rrjetet sociale dhe se për këtë ishte kritikuar prej ekspertëve të artit. Por, duket se bukuroshja hollivudiane ka ndryshuar mendim dhe ka hapur llogari zyrtare edhe në rrjetin social "Instagram". Madje artistja ka publikuar edhe fotografinë e parë në këtë rrjet social që ka marrë mijëra pëlqime brenda 24 orëve.

# Migos publikojnë videoklipin "Narcos"



Grupi i njohur Migos ka publikuar projektin e ri të titulluar "Narcos". Videoklipi është realizuar në një vilë luksoze. Migos aktualisht është top grupi amerikan me më së shumti dëgjueshmëri në tregun muzikor amerikan.

# DRENICA NË KRYENGRITJET E VITEVE 1913-1



**Dr. sc. Fitim RIFATI**
***Instituti i Historisë - Prishtinë***

Pushtimi serb e malazez i Kosovës në tetor-nëntor të vitit 1912 dhe aneksimi i dhunshëm i saj në kuadër të Mbretërisë së Serbisë dhe Mbretërisë së Malit të Zi më 1913, si pasojë e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, u shoqërua me qëndresën e armatosur të shqiptarëve në mbrojtje të viseve të tyre. Drenica ishte vazhdimisht aktive në përpjekjet e armatosura për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Kjo trevë shqiptare në gjirin e saj kishte një lëvizje të organizuar dhe të armatosur, e cila pavarësisht se nuk mund të realizonte praktikisht idealet e saj, nuk e la të qetë administratën e dhunshme ushtarake e policore serbe. Kjo lëvizje, për aq sa kishte fuqi njerëzore-luftarake, luante edhe rolin e mbrojtësit të popullsisë shqiptare nga shtypja serbe. Në këtë studim, sillet një dimension i ri burimesh e informacionesh, të cilat të mbështetura në dokumente kryesisht të proveniencës austro-hungareze, paraqesin risi momentesh e personalitetesh. Ky studim nuk anashkalon as burimet dokumentare e historiografike serbe, të cilat përligjin veprimet e autoriteteve serbe ndaj shqiptarëve dhe përpiqen të shpërfillin e minimizojnë karakterin dhe rëndësinë e qëndresës shqiptare. Në këtë kuadër, duke analizuar e krahasuar dokumentet, shtypin e kohës dhe literaturën historiografike, është synuar maksimalisht që kjo çështje të trajtohet objektivisht.

## Përkufizimi gjeografik i Kryengritjes dhe statusi administrativ i Drenicës

Drenica shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në mes të rrafshit të Kosovës dhe të Dukagjinit. Në lindje kufizohet me malin e Goleshit dhe të Çyçavicës, në veri me malin Mokna, në perëndim me Rrafshin e Dukagjinit, Kosmaçin, malet e Berishës dhe në jug me malet e Caralevës. Ka pozitë gjeografike kryesisht kodrinore dhe malore. Konfiguracioni i terrenit gjeografik në Drenicë ishte i përshtatshëm për shqiptarët, që në këto vite të fshiheshin nga ndjekjet e vazhdueshme të organeve të administratës ushtarake dhe policore serbe. Në mungesë të arsenalit luftarak dhe numrit të forcave njerëzore-kryengritëse, terreni kodrinor dhe malor i krijonte mundësi shqiptarëve për të organizuar dhe funksionuar veprimtarinë e luftës së befasishme (guerile). Veç kësaj, kryengritësit gëzonin përkrahje në pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht në familjet e tyre dhe rrethin familjar lehtë gjenin strehim dhe ushqim gjatë gjithë kohës sa vepronin dhe përndiqeshin prej pushtetit serb. Një rol të rëndësishëm në mbështetje të tyre ka dhënë edhe femra e gruaja shqiptare, e cila krahas kujdesit familjar angazhohej në furnizimin e kryengritësve me ushqime e armatim dhe në disa raste merrte pjesë drejtpërdrejtë në aksione e beteja kundër armikut.

Lëvizja e qëndresës së armatosur në Kosovë, përfshi edhe Drenicën, kundër pushtimit dhe administrimit serb, ka vijuar aktivitetin e saj edhe në fillim të vitit 1913 dhe përgjatë tërë këtij viti. Menjëherë pas pushtimit serbo-malazez të Kosovës dhe viseve të tjera, organet pushtuese serbe e malazeze morën masa për të eliminuar administratën dhe institucionet e periudhës osmane dhe nxorën ligje e mekanizma të administrimit ushtarak, policor, gjyqësor e financiar, të lidhura drejtpërdrejtë me dikasterët përkatës në Beograd dhe Cetinë. Pas ligjësimit të aneksimit serbo-malazez të Kosovës nga Fuqitë e Mëdha, Ministria e Punëve të Brendshme e Mbretërisë së Serbisë, më 18 gusht 1913, në bazë të dekretligjit që ishte hartuar enkas për viset e "çliruara", i ndau ato në 11 qarqe, të cilat drejtoheshin nga prefektët. Qarqet u ndanë në 46 rrethe që drejtoheshin nga nënprefektët. Rrethet u ndanë në njësi më të vogla administrative (komuna), të cilat drejtoheshin nga kryetarët. Viset e Kosovës përfshiheshin në Qarkun e Kumanovës, në Qarkun e Pazarit të Ri, në Qarkun e Prizrenit, në Qarkun e Prishtinës dhe në Qarkun e Shkupit. Mikroregjioni i Drenicës hynte në kuadër të Qarkut të Kosovës dhe të Pazarit të Ri. Në nëntor të vitit 1913, organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme krijuan edhe Qarkun e Zveçanit, i cili e kishte qendrën në Mitrovicë, në kuadër të të cilit hynin: Rrethi i Mitrovicës, i Vushtrrisë dhe i Drenicës me qendër në Deviç. Nga 14 marsi i vitit 1914, qendër e Rrethit të Drenicës u bë Llausha. Rrethi administrativ-territorial i Drenicës përfshinte 7 komuna, 72 fshatra, 7 lagje e 1 manastir, që përgjithësisht numëronte 23.821 banorë. Veç një pjese të vogël serbësh në Bajë, Runik, Kostërc e Llaushë, në Rrethin e Drenicës jetonte vetëm popullsia shqiptare. Në këtë kuadër, duke qenë se kjo trevë banohej kryesisht me shqiptarë, organizimi dhe veprimtaria e lëvizjes së rezistencës së armatosur ishte pjesërisht më e lehtë krahas rretheve e krahinave të tjera ku kishte popullsi etnikisht të përzier ose fshatra të banuara me minoritet serb. Elementi serb, që prej pushtimit dhe aneksimit të Kosovës mori pjesë në aksione të armatosura kundër shqiptarëve dhe bashkëpunoi me administratën serbe. Prandaj, përderisa mungonte shtrirja e këtij elementi në të gjithë Drenicën, atëherë edhe mundësia e shpartallimit të qëndresës shqiptare ishte më e vogël.

## Drenica në Kryengritjen e vitit 1913 dhe terrori serb ndaj shqiptarëve

Shkaqet kryesore që nxitën shqiptarët për të organizuar qëndresë të armatosur ishin: reprezaljet shtetërore, administrative, ushtarake e civile serbo-malazeze ndaj shqiptarëve, që u manifestuan me grabitje, plaçkitje, gjoba, taksa e tatime të papërballueshme; rekuizime, sekuestrime, punë të detyrueshme dhe angari; cenim të besimit fetar dhe nderit në familje; ekspedita ushtarake ndaj shtëpive dhe vendbanimeve, shpërfillje e ankesave të shqiptarëve nga organet e administratës dhe qeverisë; mërzitje, përpëlitje, keqtrajtime, torturë, violencë, burgosje, internime, djegie me pretekst të shtëpive dhe vendbanimeve; pushkatime, vrasje e masakra; mosgjykim e mosndëshkim të krimeve etj. Pra, shqiptarët u detyruan të zgjedhnin rrugën e kryengritjes, për t'i shpëtuar shtypjes, asimilimit dhe likuidimit.

Historiografia serbe është e prirë që lëvizjen e qëndresës së armatosur në Kosovë, madje në mënyrë të veçantë edhe në Drenicë, ta shoh të lidhur me rrjedhat politike në Ballkan. Kështu, në kohën e përfundimit të Luftës së Dytë Ballkanike, në korrik dhe në gusht të vitit 1913, krerët shqiptarë të Drenicës, gjoja duke shfrytëzuar dislokimin e trupave ushtarake serbe në frontin me Bullgarinë, organizuan lëvizjen e armatosur kundër pushtimit serb. Mirëpo, reagimi i menjëhershëm i organeve ushtarake dhe policore serbe, kishte ndikuar që kjo lëvizje të shpartallohej në fillesat e saj. Rrjedhimisht, shqiptarët e armatosur u thyen, krerët kryesorë u vranë dhe në shenjë dënimi shtëpitë e gjithë pjesëmarrësve u dogjën. Deri në fillim të muajit gusht, qarqet ushtarake serbe në Drenicë, vlerësonin se në këtë krahinë paqja ishte mbizotëruesja e vetme. Në të vërtetë prijësit shqiptarë të Kosovës, por edhe popullsia civile, refuzuan të bashkëpunonin me organet serbe, por vetëm me prijësit e tyre në Shqipëri, si: Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri etj. Për këtë arsye, pa zbatuar procedura gjyqësore, shqiptarët u burgosën, u izoluan, u internuan dhe u vranë. Në mesin e tyre ishin edhe krerë të shquar të Lëvizjes Kombëtare nga Drenica, si: Halil Haxhia nga Vitaku, Hetem Kozhica nga Kozhica, Fejzullah Lubaveci nga Lubaveci, Temë Dobrosheci nga Dobrosheci, Rexhep Bajraktari nga Llausha, Ramadan Bajraktari nga Klina dhe tetëmbëdhjetë prijës të tjerë, të cilët organet ushtarake serbe, përkitazi me politikën shtetërore ndaj shqiptarëve, i ekzekutuan në Kaçanik.

Historiani Islam Dobra, i cili ka shkruar gjerësisht për rolin dhe kontributin e krerëve të Drenicës në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, në bazë të shënimeve të grumbulluara prej bashkëkohësve në terren, konstaton se këta prijës të shquar u likuiduan në mes të Vushtrrisë dhe Mitrovicës, pas një kohe të pushtimit serb të Kosovës, duke mos specifikuar datën, muajin dhe vitin.

Vrasja e këtyre krerëve të Drenicës bëri përshtypje të madhe në Kosovë dhe në shtypin ndërkombëtar. Ajo ishte një mesazh për prijësit e tjerë, që t'i shpëtonin aksionit të organeve serbe për likuidimin fizik të të gjithë krerëve shqiptarë. Kësisoj, Jetullah Vojniku nga Vojniku i Drenicës, së bashku me 60 bashkëveprimtarë të tij, u arratis në Shqipëri. Për pasojë, ashpërsimi i raporteve ndëretnike mes shqiptarëve dhe serbëve u rrit për një shkallë. Kështu, serbët e fshatit Llaushë u zhvendosën në Vushtrri, ndërsa 40 familje serbe nga Peja u shpërngulën në Runik. Ndërkohë, më 8 shtator 1913, nga Koshtova dhe Selaci i Mitrovicës shkuan në Drenicë 14 përkatësisht 13 shqiptarë. Kjo situatë e tensionuar ndikoi që asnjë shqiptarë nga Drenica të mos shkonte më të vizitonte tregun në Mitrovicë. Në anën tjetër,



organet administrative serbe i nuhatën lëvizjet e shqiptarëve dhe paraprakisht vendosën të armatosnin elementin serb, në mënyrë që të jetë i gatshëm për një përleshje të armatosur përkrah ushtrisë serbe kundër shqiptarëve. Këto raste tregonin më së miri se në Drenicë po fillonte riorganizimi i veprimeve të armatosura kundër shtypjes, pushtimit dhe aneksimit serb e malazez të Kosovës.

## Kuvendi i Llaushës dhe vendimet e tij

Në të njëjtën kohë, krerët e Lëvizjes Kombëtare, të cilët vepronin në Vlorë në kuadër të përpjekjeve për konsolidimin shtetëror të Shqipërisë, si: Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri, Riza Gjakova e Mehmet Derralla, vlerësuan të rëndësishëm armatimin e popullsisë së Kosovës, përfshi edhe Drenicën. Me urdhër të tyre dhe në kanale të fshehta, në Drenicë arriti sasi armatimi, e cila iu shpërnda popullsisë dhe veçanërisht burrave e djemve të gatshëm për luftë. Organizimin e Kryengritjes e ndihmoi edhe

# 914 DHE TERRORI SERB NDAJ SHQIPTARËVE



*Masakrimi i shqiptarëve nga ushtria serbe*

roli i Komitetit ose Shoqërisë "Shkipnia", në gjirin e së cilës ishin tubuar prijës të shquar të Lëvizjes Kombëtare nga të gjitha viset shqiptare. Ajo krijoi dhe mbajti lidhje me të gjitha viset e Kosovës, përfshi edhe Drenicën. Në këtë kontekst, në gusht të vitit 1913, në Llaushë u mbajt një kuvend i shqiptarëve, në të cilin u mor vendim që Drenica të bashkohet me Kryengritjen dhe të japë kontributin e saj në luftën për çlirimin e viseve shqiptare nën pushtimin dhe aneksimin serb e malazez.

Nuk vonoi aspak kur veprimet e armatosura nisën në zonën e Drenicës. Më 9 shtator 1913, në afërsi të fshatit Pemishtë (Padalishtë), përkatësisht në rrugën Mitrovicë-Pejë, kryengritësit shqiptarë vranë një oficer dhe dy ushtarë malazezë, që po shoqëronin një kolonë transporti me misër. Gjoja për t'i mbrojtur nga "sulmet e befasishme dhe qëllimet plaçkitëse të shqiptarëve", organet e administratës ushtarake serbo-malazeze në Kosovë vëzhgonin në vazhdimësi transportet e mallrave. Mirëpo, përkundër kësaj, më 11 shtator 1913, autoritetet serbe në Rrethin e Mitrovicës, shpallën edhe zyrtarisht aneksimin e Kosovës Mbretërisë së Serbisë dhe Malit të Zi. Ato organizuan një festë, në të cilën mori pjesë minoriteti serb, kurse të shtënat me rastin e kësaj feste u bënë të pandërprera dhe valëvitja e flamurit kombëtar serb u bë në mënyrë entuziaste. Përkundrazi, aneksimin serbo-malazez të Kosovës nuk e pranuan shqiptarët, që konsideronin se vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe aneksimi i trumbetuar nga organet administrative serbe, ishin akte të padrejta dhe cenonin aspiratat e qenien kombëtare të popullit shqiptar dhe trojeve të tij.

Në një raport të datës 19 shtator 1913, të konsullatës austro-hungareze në Mitrovicë, përkatësisht përgjegjësit të saj Josef Umlauf, provohet se në Drenicë ekzistonte një gatishmëri e shqiptarëve që t'i përgjigjeshin thirrjeve të Isa Boletinit, për të shkuar në Shqipëri dhe për t'iu bashkuar radhëve të kryengritësve. Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Serbisë në Beograd ishte e shqetësuar mbi rolin dhe ndikimin që Hasan Prishtina dhe Isa Boletini kishin në Shqipëri dhe veçanërisht në organizimin e shqiptarëve, për të ndërmarrë veprime të armatosura kundër pushtimit e pushtetit serb në Kosovë. Ajo, përmes një qarkoreje i informonte të gjitha ambasadat se në tre muajt e fundit, Hasan Prishtina e Isa Boletini kishin arritur të siguronin dhe furnizonin me armatim kryengritjen e shqiptarëve në Kosovë, përfshirë edhe Drenicën. Për këtë arsye, Qeveria serbe kishte vendosur të merrte masa për përforcimin e rojeve ushtarake në kufi me Shqipërinë. Mirëpo, numri i shqiptarëve që niseshin drejt Shqipërisë rritej pothuajse çdo ditë. Burrat e aftë për luftë dhe të guximshëm, përkundër rrethanave të vështira të kohës, lan të vetme familjet e tyre, të pambrojtura dhe me ushqime të pakta.

## "Dezertimi" i Ajet Çaushit

Në mesin e prijësve të Drenicës ishte edhe Ajet Çaushi. Ai, pas pushtimit serb të Kosovës, ishte shtrënguar të inkuadrohej në radhët e administratës ushtarake serbe, duke shërbyer në sektorin e xhandarmërisë në kuadër të Rrethit të Mitrovicës. Në verë të vitit 1913, kur autoritetet e administratës ushtarake kishin krijuar besim në personalitetin e tij, me rastin e festës së Bajramit Ajet Çaushi mori një leje pushimi për dhjetë ditë, pas të cilës nuk u kthye më të shërbente në sektorin e xhandarmërisë. Veprimi i Ajet Çaushit nënkuptonte se ai u njoh për së afërmi me qëllimet shtetërore serbe ndaj Kosovës, prandaj vendosi që këtë pushtet ta luftonte deri në frymën e fundit. Në raportin e J. Umlauf vihet në dukje se pas këtij veprimi, Ajet Çaushi në Duboc të Drenicës "mblodhi rreth vetes 30 shokë, u nis nga Drini, ku një patrullë e fortë e pengoi kalimin. Ai e sulmoi patrullën dhe pasi i kishte shkaktuar asaj një humbje prej 7 të vdekur e 6 të plagosur, u kthye në Drenicë". Në dokumentet serbe personaliteti i Ajet Çaushit identifikohet me emrin Keço Ajriz Çaushi nga Kotorri i Drenicës. I biri i tij, Hasani, ishte ndër prijësit kryesor dhe protagonist në Kryengritjen e vitit 1914. Me rastin e "dezertimit" të Ajetit nga administrata e Rrethit të Mitrovicës, dokumentet serbe japin si arsyetim se ai, pasi iu lut djemve të tij, Hasanit, Sinanit dhe Nuriut, të ktheheshin nga Shqipëria në Drenicë, gjë që u refuzua prej tyre, vendosi të heq dorë nga shërbimi i mëtejshëm dhe me 30 shokë të tij të niset në drejtim të Shqipërisë.

Veprimi i Ajet Çaushit la përshtypje të thellë në Drenicë e viset përreth. Për arrestimin dhe vrasjen e tij u angazhuan madje edhe vet drejtuesit administrativë të rretheve. Kësisoj, kryetari i Rrethit të Vushtrrisë, iu bashku aksionit për kapjen e Ajet Çaushit, për të cilin siguroi informacione se ndodhej në fshatin Abri. Me urdhrin e Kryetarit u shkatërrua shtëpia ku ndodhej Ajet Çaushi. Sipas J. Umlauf "Ajet Çaushi, i lajmëruar për praninë e naçellnikut (kryetarit, F.R), e priti në rrugë dhe shtriu për tokë një xhandar. Naçellniku iku në Vuçitërn (Vushtrri, F.R)". Megjithëkëtë, vala e largimit të shqiptarëve të aftë për luftë nga Drenica, për t'iu bashkuar qendrës së Kryengritjes dhe drejtuesve të saj në Shqipëri, nuk u ndal. Natën e 12 dhe mëngjesin e 13 shtatorit 1913, "rreth 200 shqiptarë të armatosur qenkan arratisur nga rrethi i Mitrovicës dhe nga Drenica". Rrjedhimisht, edhe udhëtimet nga një fshat në tjetrin bëheshin të vështira dhe të pasigurta, për shkak të gjendjes kritike, të tensionuar dhe me tipare të paraluftës. Sipas shtypit serb, një strategji e furnizimit me armë, e cila u përdor para dhe gjatë Kryengritjes së shtatorit 1913, ishte aktivizimi i gruas, e cila "i mbushte bukët me fishekë" dhe ia dërgonte kryengritësve. Jo vetëm kaq, qarqet gazetareske serbe kishin informacione të hollësishme mbi pjesëmarrjen e gruas shqiptare në radhët e kryengritësve. Sipas tyre, shqiptarët "që bëjnë luftë shoqërohen prej grave të tyre, të cilat kanë me vete ushqimin për burrat". Në këtë kontekst, qëllimi i shtetit serb ishte "dëbimi i atyre që kanë depërtuar në territorin e Kosovës dhe rivendosja e rregullit". Ky qëndrim nënkuptonte se shteti serb nuk do të përzgjidhte forma të lehta për realizimin e qëllimit të tij, duke mos kursyer të gjitha shtresat shoqërore shqiptare, pa dallim gjinie dhe moshe. **(Vijon)**




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | URUGUAY - PORTUGAL | GG | FRANCE - ARGENTINA | PX | CRICIUMA SC - SAO BENTO | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# 'Nxehet' Kupa e Botës, fillon faza e eliminimit të drejtpërdrejtë




Kupa e Botës, pas një dite pushimi, rikthehet me dy ndeshje mjaft të forta në kuadër të 1/8 së finales. Nga ora 16:00 përballen Franca - Argjentina, kurse në orën 20:00 Uruguai - Portugalia. Fituesit e këtyre ndeshjeve përballen në çerekfinale ndërmjet vete

"Epoka e re"

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Faza eliminuese në Kupën e Botës "Rusi 2018 do të fillojë me një ndeshje të fortë në mes të kombëtareve të mëdha që këtë kompeticion e filluan me synime të mëdha, Francës dhe Argjentinës. Këto kombëtare që synojnë kualifikimin në çerekfinale nuk kanë pasur paraqitje të mira në fazën e grupeve. Franca e kaloi e para grupin, por fitoret e saj ndaj Australisë dhe Perusë nuk ishin bindëse, sikurse që nuk ishte paraqitja në barazim ndaj Danimarkës. Ndërsa argjentinasit e kishin edhe më të vështirë kualifikimin, pasi luajtën baras me Islandën dhe pësuan humbje të thellë nga Kroacia, derisa në ndeshjen e fundit mezi e mposhtën Nigerinë pak minuta para përfunduar të ndeshjes. Argjentina e fitoi dy herë Kupën e Botës 1978 dhe në vitin 1986, kurse Franca e fitoi vetëm një herë në vitin 1998, kurse e mposhti Brazilin me rezultat 3-0. Samuel Umtiti është në dyshim për këtë ndeshje, derisa rikthehen Hugo Lloris, Paul Pogba dhe Kylian Mbappe. Argjentina nuk ka probleme me lëndime dhe 11-shja pritet të jetë ashtu sikurse në ndeshjen ndaj Nigerisë. Uruguai do të kërkojë ta vazhdojë garën në Kupën e Botës edhe pas ndeshjes me Portugalinë. Fituesi i kësaj sfide do të përballet në çerekfinale me fituesin e ndeshjes Francë - Argjentinë. Uruguai ka pasur paraqitje të mira në fazën e grupeve, ku ka fituar tri ndeshjet kundër Rusisë, Egjiptit dhe Arabisë Saudite, derisa Portugalia filloi këtë kompeticion me një goditje 3-3 ndaj Spanjës dhe një fitore 1-0 kundër Marokut, por ndeshja e tyre e fundit kundër Iranit përfundoi 1-1. Cristiano Ronaldo që ka realizuar katër gola për Portugalinë do të përballet me sulmuesin Luis Suarez të Barcelonës dhe Edinson Cavanin të Paris Saint Germainin. Jose Maria Gimenez mund të kthehet në formacion të Uruguait, kurse Portugalia nuk ka shqetësime sa iu përket lëndimeve.

### FORMACIONET E MUNDSHME

**FRANCA:** Lloris, Pavard, Varane, Kimpembe, Mendy, Pogba, Kante, Mbappe, Griezmann, Lemar, Giroud.
Argjentina: Armani, Mercado, Otamendi, Rojo, Tagliafico, Banega, Mascherano, Meza, Messi, Higuain, Di Maria.

**URUGUAI:** Muslera, Caceres, Gimenez, Godin, Laxalt, Nandez, Vecino, Torreira, Bentancur, Suarez, Cavani.
Portugalia: Patricio, Cedric, Pepe, Fonte, Guerreiro, B. Silva, Carvalho, Moutinho, Fernandes, Ronaldo, Guedes.

## SHKURT

### Dardan Berisha: Nuk ishin të fokusuar në ndeshje

Kapiteni Dardan Berisha, pas humbjes nga Hungaria, ka thënë se basketbollistët nuk ishin të përgatitur mirë dhe as të fokusuar për ndeshje, pas rastit tragjik që ndodhi ditë më parë, nga i cili humbi jetën basketbollisti Gazmend Sinani. "Nuk e kemi pasur mendjen te ndeshja, nuk kemi mundur të fokusohemi. Gazi nuk është më me ne dhe kjo është një humbje mjaft e madhe. Ne nuk jemi stërvitur dhe nuk jemi përgatitur shumë për këtë ndeshje pas rastit tragjik. Na kanë munguar lojtarët si Granit e Fisnik Rugova. Kemi rezistuar shumë mirë tre çerekët e parë, por në fund ishim të lodhur dhe nuk kishim rezerva të mira. Jam i lumtur për paraqitjen e lojtarëve të ri. Shihet se Kosova ka brumë për basketboll. Kjo është humbja më e ëmbël në karrierën time", ka thënë Berisha.

### Bayerni nis lojën ndaj Hoffenheimit

Shorti i Bundeligës për sezonin 2018-2019 është hedhur të hënën. Ndryshe nga herët e tjera, kampionati gjerman këtë sezon do të nisë më 24 gusht për shkak të Botërorit. Kampioni i Gjermanisë, Bayern Munchen, në ndeshjen hapëse do të ndeshet ndaj Hoffenhaimit. Përballje interesante në javën e parë do të jetë ajo mes Borussia Dortmundit dhe Leipzingut. Sfidën e fundit të kampionatit Bayerni do ta zhvillojë ndaj Frankfurtit.

### Jamesi shqetëson Kolumbinë

James Rodriguez pas gjysmë ore lojë ndaj Senegalit është dashur të largohet nga loja për shkak të një lëndimi, i cili është duke e shqetësuar skuadrën e Kolumbisë. Nëse James nuk rikthehet për ndeshjen e 1/8 së finales do të ishte një goditje e madhe për Kolumbinë e cila takohet me Anglinë.

### Berisha lë Australinë për Japoninë

Besart Berisha largohet nga Melbourne Victory dhe nga futbolli australian. Ish-sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës dhe Kombëtares së Shqipërisë, pas shtatë vjetësh në kontinentin e kangurëve, ka vendosur ta vijojë karrierën në Japoni te Sanfrece Hiroshima. 32-vjeçari, pasi fitoi gjithçka në Australi, ku fitoi 4 tituj kampion me Brisbane Roar dhe Melnourne Victory, ka vendosur të hedhë një tjetër hap në karrierë. Berisha ka shënuar në total 116 gola në kampionatin e Australisë si dhe ka fituar 2 herë Këpucën e Artë. Duke folur për këtë lëvizje të tij, Berisha tha se ka marrë vendimin e duhur. "Kam emocione të përziera tani, pasi kam kaluar një përvojë shumë të mirë te Viktoria dhe në Australi. E kam pak të vështirë tani, por është vendimi i duhur për t'u larguar. Dua t'i falënderoj tifozët që më kanë përkrahur në çaste të mira, por dhe në kohë të vështira", ka thënë Berisha.

## Loriana Kuka, e argjendtë në Lojërat Mesdhetare

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Xhudistja Loriana Kuka e ka fituar medaljen e argjendtë në Lojërat Mesdhetare që po mbahen në Spanjë. Loriana në çerekfinale e mposhti spanjollen Laia Talarn derisa në gjysmëfinale triumfoi ndaj sllovenes Patricia Brolih në kategorinë -78 kg. Në finale Loriana u mposht nga italiania Giorgia Stangherlin në kategorinë 78 kilogramë, por ia sjell Kosovës medaljen e katërt nga këto lojëra, pasi më herët medaljet e arta i siguruan Akil Gjakova, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi. I pranishëm të premten në Lojërat Mesdhetare për t'i mbështetur sportistët e Kosovës ishte edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi.



## Januzaj heshtë kritikët pas ndeshjes me Anglinë

LONDËR, 29 QERSHOR - Adnan Januzaj ishte kritikuar shumë pas largimit nga Manchester Unitedi, madje talenti i tij ishte vënë në pikëpyetje. Megjithatë, lojtari me orgjinë shqiptare ka shkëlqyer në ndeshjen që Belgjika e fitoi ndaj Anglisë (0-1) dhe u shpall nga FIFA lojtar i ndeshjes. "Natyrisht puna ime ishte ta tregoja veten para njerëzve se në të kaluarën në Angli kisha shumë kritika. Dua t'u tregoj atyre njerëzve se jam këtu, jam shumë i kënaqur me këtë. Jam shumë i lumtur që shënova një gol të shkëlqyer kundër një kundërshtari të mirë. Unë kam shpenzuar shumë energji në punë. Këtë vit kam luajtur në një ekip si Real Sociedadi që më ka bërë të rritem si lojtar. Në moshën 23-vjeçare gjëja më e rëndësishme është të kesh paraqitje në fushë dhe të vazhdosh të përparosh. Jam shumë i kënaqur që po shkon në këtë mënyrë", ka thënë Januzaj për mediet britanike.



# Faza e grupeve e Botërorit në shifra dhe kuriozitete

MOSKË, 29 QERSHOR - Me përfundimin e fazës në grupe, Botërori "Rusi 2018" do të bëjë një ditë pushim, para se të vijojë me takimet e fazës së 1/8-ave, ndërsa tashmë është koha e bilanceve për këtë pjesë të parë. Janë luajtur në total 48 ndeshje, nga të cilat vetëm 9 kanë përfunduar në barazim dhe nga këto, vetëm një ka përfunduar në barazim pa gola. Në total janë shënuar 122 gola, një shifër e kënaqshme dhe me një mesatare prej afërsisht 2.5 golash për ndeshje. Vlen të përmendet se 16 gola janë shënuar me penallti dhe 9 kanë qenë autogola. VAR-i u konfirmua si risi dhe si protagonist në këtë Botëror, pasi janë akorduar plot 24 penallti, pra mesatarisht një 11-metërsh në çdo dy ndeshje. Nga këto janë shndërruar në gola 18 dhe janë pritur nga portierët ose kanë përfunduar jashtë kuadratit 6. Vetëm 3 skuadra arritën të marrin 9 pikë të plota në grupe, dhe këto janë Uruguai, Kroacia dhe Belgjika. Ndërsa Gjermania u eliminua që në fazën e grupeve, ku u renditën të fundit me vetëm 3 pikë dhe me një golavarazh -2.



Kjo ishte hera e parë për gjermanët që nuk ia dolën të kalojnë fazën e grupeve, në historinë e kampionateve botërorë. Për herë të parë që nga viti 1982, në fazën e 1/8-ave nuk kualifikohet asnjë skuadër afrikane. Fillimisht Egjipti dhe më pas me radhë Maroku, Nigeria, Senegali dhe Tunizia, i dhanë lamtumirën Rusisë. Japoni bëhet e para skuadër që kualifikohet në fazën e 1/8-ave të një botërori, falë "fair-play"-të. Aziatikët e mbyllën fazën në grupe në kuotën e 4 pikëve, dhe me golavarazh 4-4, po aq sa Senegali. Edhe sfida direkte mes këtyre skuadrave kishte përfunduar në barazim 2-2, ndaj Japonia avancoi më tej sepse kishte më pak kartonë të verdhë. Golashënuesi më i mirë i fazës së grupeve është Harry Kane me 5 gola të shënuar, i ndjekur nga Cristiano Ronaldo dhe Romelu Lukaku me nga 4 të tillë. Ndërsa sulmuesi i Kroacisë, Nikola Kaliniç u bë futbollisti i parë që i dha lamtumirën Botërorit. Ai u përjashtua nga trajneri kroat Daliç, vetëm dy ditë pas ndeshjes së parë të Kroacisë, ndaj Nigerisë.

# Rriten premitë e Wimbledonit




LONDËR, 29 QERSHOR - Organizatorët e grand slemit të Wimbledonit kanë bërë publike premitë që do të japin për tenistët që do të marrin pjesë në turneun londinez, që nis më 2 korrik. Në total, do të jenë 46.57 milionë dollarë në dispozicion të tenistëve, të cilat do të ndahen në mënyrë të barabartë mes femrave dhe meshkujve. Kjo shumë është 7.6 % më e madhe se një vit më parë, por më e vogël se ajo e grand slemit të US Open dhe Roland Garros. Fituesit do të marrin një çek me vlerën e 3 milionë dollarëve, ndërsa finalistët 1.5 milion dollar. Edhe tenistët që do të eliminohen që në raundin e parë do të fitojnë një shumë të kënaqshme, 53 mijë dollarë, e cila do të rritet ndjeshëm nga raundi në raund.

**PREMITË E TENISTËVE SIPAS RAUNDEVE**

**Fituesi: 3.08 milionë dollarë**
**Finalisti: 1.5 milion dollarë**
**Gjysmëfinale: 769 000 dollarë**
**Çerekfinale: 384 000 dollarë**
**Raundi IV: 223000 dollarë**
**Raundi III: 136 000 dollarë**
**Raundi II: 86000 dollarë**
**Raundi I: 53 000 dollarë**

SHKURT / "RUSI 2018"

### Shqiptarët kanë shënuar më shumë se ekipi serb në Botëror

Katër futbollistë shqiptarë janë pjesë e Kupës së Botës "Rusi 2018". Grani Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Blerim Xhemaili kanë shënuar gola për Zvicrën, kurse Adnan Januzaj ka shënuar për Belgjikën. Katër golat e shënuara nga këta futbollistë janë më shumë se disa përfaqësuese. Ndërkohë Serbia ka shënuar vetëm dy gola. Ballkanasit një gol ia shënuan Kosta Rikës dhe një tjetër Zvicrës. Pra, shqiptarët kanë shënuar më shumë gola se gjithë ekipi serb në botëror.

### Rakitiqi: Nuk është rastësi që Danimarka është pa humbje

Kroacia ka shkëlqyer në këtë kampionat, duke fituar tri ndeshjet e fazës së grupeve. Në 1/8 e finales, Kroacia do të takohet me Danimarkën më 1 korrik, në Nizhny Novgorod. Lidhur me këtë ndeshje Ivan Rakitiq ka deklaruar: "Danimarka është një ekip shumë serioz, nuk është një rastësi që ka ardhur deri këtu pa humbur. Kemi të bëjmë me një ekip kompakt, që e di mirë se çfarë të bëjë, si ta ndalë kundërshtarin. Ka shanse për të shënuar dhe mund të jetë shumë e rrezikshme në sulm, shumë e shpejtë. Lojtari kryesor danez është Christian Eriksen, një nga krijuesit më të mirë të futbollit evropian".

### Kroosi mendon largimin nga kombëtarja

Toni Kroos ndoshta ishte ndër lojtarët e paktë të Gjermanisë që lanë gjurmë në këtë Botëror, sidomos me golin e fitores në minutën e 95-të kundër Suedisë, por që në fund nuk vlejti për asgjë. Por më e keqja është se duke parë këtë dështim dhe gjithçka mund të ketë ndodhur në këtë grup edhe në prapaskenë, mesfushori i kombëtares dhe i Realit të Madridit ka pranuar se po mendon tërheqjen, edhe pse vetëm 28-vjeçar. "Mendoj se në Rusi do të kishim bërë një rrugë më të gjatë. Nëse kjo nuk do të kishte ndodhur, nuk do të më shkonte mendja tek ideja e tërheqjes, por pas këtij dështimi do ta mendoj largimin nga kombëtarja", ka thënë Kroosi.

### Chelsea nuk e shet Williamin për 50 milionë funte

Barcelona i ka ofruar Chelseat shumën e 50 milionë funteve për brazilianin Willian, por klubi anglez e ka refuzuar menjëherë këtë ofertë të Barçës. Lajmi është bërë me dije nga "Daily Mail". Barcelona është duke e kërkuar një zëvendësues për Andreas Iniestën dhe 29-vjeçari William është para si zëvendësues ideal. Mirëpo, Chelsea nuk është e interesuar ta lëshojë yllin e saj nëse nuk ofrohet ndonjë shumë më e lartë.

### Spanja me ndryshime në formacion ndaj Rusisë

Spanja me ndryshime në duelin ndaj Rusisë në 1/8 e finales në Kampionatin Botëror 2018. Mediet spanjolle raportojnë se Fernando Hierro është i gatshëm ta inkuadrojë Koken në vend të Thiago Alcantaras. Po ashtu, ai dëshiron t'i japë një shans të ri yllit të Real Madridit, Marco Asensio, për t'i treguar aftësitë e tij në formacionin bazë. Por, në portë nuk do të ketë ndryshime ku David de Gea vazhdon ta ketë besimin e tij.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 111/01-20565 /2018
Kaçanik, 29.06.2018

Në bazë të nenit 5 pika (c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, neni 7 pika 4 e Udhëzimit Admnistrativ MASHT nr.32/2013 Organizimi i Kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e Arsimit Prauniversitar, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpallë:

## KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të Komunës së Kaçanikut për vitin shkollor 2018/2019.

**1.Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Emin Duraku'' në Kaçanik:**
Një mësimdhënës i mësimit klasor, zëvendësim (pushim i lehonisë).
Një mësimdhënës i lëndës së Gjuhës Gjermane, me 12 orë, me plotësim norme në Gjimnazin "Skënderbeu" Kaçanik.
Një mësimdhënës i lëndës së Fizikës, zëvendësim (pushim i lehonisë).
Një mësimdhënës i lëndës së Teknologjisë Informative, zëvendësim (pushim i lehonisë).
- **Paralelja e ndarë fizike në Gjurgjedell:**

Një mësimdhënës i mësimit klasor me klasë të kombinuara.
- **Paralelja e ndarë fizike në Kërbliq:**

Një mësimdhënës i mësimit klasor me klasë të kombinuara.

**2. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Idriz Seferi'' Bob:**
Një mësimdhënës i mësimit klasor.
Një mësimdhënës i lëndës së Gjuhës Gjermane, 7 orë, me plotësim norme në shkollat fillore të mesme të ulëta: "Jusuf Gërvalla" Biçec, 5 orë, në "Ali Asllani " Doganaj , 4 orë dhe "Nazmi Osmani" Elezaj, 5 orë.

**3. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Nazmi Osmani'' në Elezaj:**
Një mësimdhënës i mësimit klasor, paralelja e ndarë fizike Bajnicë, zëvendësim (pushim i lehonisë).

**4. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Dituria'' në Ivajë:**
Një mësimdhënës i mësimit klasor .
- **Paralelja e ndarë fizike në Strazhë:**

Një mësimdhënës i mësimit klasor me klasë të kombinuara.

**5. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Qamil Ilazi'' në Kaçanik i Vjetër:**
Dy mësimdhënës të mësimit klasor.

**6. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Jusuf Gërvalla" Biçec:**
Një mësimdhënës i lëndës së Gjuhës Angleze, zëvendësim (pushim i lehonisë).
Një e mësimdhënës i lëndës së Edukatës muzikore me 10 orë, dhe në SHFMU "Idriz Seferi" paralelja e ndarë fizike Gajre, 4 orë.

**7. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Naim Frashëri'' në Kotlinë:**
Një mësimdhënës i mësimit klasor .

**8. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Ali Asllani " Doganaj:**
Një e mësimdhënës i lëndës së Edukatës muzikore, me 12 orë, zëvendësim (pushim i lehonisë).

**9. Shkolla e Mesme Profesionale "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"-Kaçanik:**
Tre mësimdhënës të lëndës së Matematikës, njëri me plotësim norme në Gjimnazin Skënderbeu".

**10. Gjimnazi "Skënderbeu" në Kaçanik:**
Një mësimdhënës i lëndës së Matematikës, për kohë të caktuar derisa mësimdhënësi i zgjedhur Drejtor në Drejtorin e Arsimit të kthehet nga detyra.
Një mësimdhënës i lëndës së Fizikës, zëvendësim (pushim i lehonisë).
Një mësimdhënës i lëndës zgjedhore Orientim në Karrierë, me 10 orë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës të shënuara më lartë :**
- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të Shkollës;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ia caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs:**
Për vendet e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.06/2015 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.
Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim: diploma e fakultetit përkatës, ekstrakti i lindjes, vërtetim për përvojën e punës në arsim dhe kopjen e letërnjoftimit.
Ndërsa, për vendin e punës Edukim në Karrierë ( lëndë zgjedhore) kërkohet: Niveli Master për Ekonomi ose Fakulteti Ekonomik -Sistemi Katërvjeçar, 5 vite përvojë punës në arsim, ekstrakti i lindjes dhe kopja e letërnjoftimit.
Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellët në ditën e intervistimit.
**Afati dhe mënyra aplikimit.**
Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar-**Zyra e Pranimit**, kati përdhes.
Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.
Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes, postës elektronike (e-mail) ose tabelës së shpalljeve publike.
**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 30.06.2018 deri 14.07.2018.**

Drejtori i drejtorisë
z. Zahir Doda

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

---

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

**Direkcija za obrazovanje i kulturu**
**04 Br . 111/01-20565 / 2018**
**Kacanik, 29.06.2018**

**U skladu sa članom 5 (c) Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03 / L-068, član 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju br. 04 / L-032, član 8 Zakona o radu br. 03 / L-212, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka javnih procedura, Administrativnog uputstva MONT br. 06/2015 O Normativu o profesionalnom okviru opšteg obrazovanja, član 7, stav 4 Administrativnog uputstva MONT br.32 / 2013 Organizovanje Izbornog kurikuluma na svim nivoima obrazovanja za diplomirane student, Direkcije za obrazovanje i kulturu objavljuju:**

## OGLLAS ZA REGRUTOVANJE

**Za popunu radnih mjesta u osnovnim, srednjim i srednjim školama u opštini Kacanik za akademsku godinu 2018/2019.**

**1. Donja srednja osnovna škola "Emin Duraku" u Kačaniku:**
**Učitelj razreda, zameni (porodiljsko odsustvo).**
**Nastavnik nemačkog jezika kursa sa 12 časova, stopa završetka na "Skenderbeg" Kačanik.**
**Fizicki predmet nastavnik, zamena (porodiljsko odsustvo).**
**Nastavnik u informacionoj tehnologiji, zameni (porodiljsko odsustvo).**
**• Fizička podela u Gjurgjedellu:**
**Učitelj u učionici sa kombinovanom učionicom.**
**• Fizička podela u Kerbliču:**
**Učitelj u učionici sa kombinovanom učionicom.**

**2. Donja srednja osnovna škola "Idriz Seferi" Bob:**
**Učitelj razreda.**
**Nastavnik kursa nemačkog jezika, 7 časova, po stopi od završetka u osnovnim i nižim srednjim školama, "Jusuf Gervalla" Bičec, pet časova, " Ali Aslani" Doganaj-, 4 časova i "Nazmija Osmani," Eleza, 5 časova.**

**3. Donja srednja osnovna osnovna škola "Nazmi Osmani" Elezaj:**
**Učitelj razreda, podeljena fizička podela Bajnice, zamena (porodiljsko odsustvo).**

**4. Donja srednja osnovna osnovna škola " Dituria" u Ivaju:**
**Učitelj razreda.**
**• Fizička podela u Strazi:**
**Učitelj u učionici sa kombinovanom učionicom.**

**5. Donja srednja osnovna škola "Ćamil Ilazi" u Stari Kačanik:**
**Dva učitelja u učionici.**

**6. Donja srednja osnovna škola "Jusuf Gervalla" Bicec:**
**Nastavnik engleskog jezika, zamena (porodiljsko odsustvo).**
**Nastavnik muzičkih obrazovnih materijala za 10 časa, a SHFMU "Idriz Seferi" paralelne fizičke Udeo Gajre 4 časova.**

**7. Donja srednja osnovna škola "Naim Frasheri" u Kotlini:**
**Učitelj razreda.**

**8. Donja srednja osnovna škola "Ali Asllani" Doganaj:**
**Jedan od nastavnika Muzičke škole, sa 12 časova zamene (porodiljsko odsustvo).**

**9. Profesionalna gimnazija "Feriz Guri i braća Çaka" -Kačanik:**
**Tri nastavnika predmeta Matematike, jedan sa standardnim dodatkom u Gimnaziji Skenderbeu ".**

**10. Gimnazija Skenderbeu u Kacaniku:**
**Nastavnik predmeta matematike, određeno vreme dok se izabrani direktor za obrazovanje kod direktora obrazovanja ne vrati sa funkcije.**
**Fizicki predmet nastavnik, zamena (porodiljsko odsustvo).**

**Dužnosti i odgovornosti za gore navedena radna mjesta:**
**• Da završi nastavni plan i program za odgovarajuće radno mesto, u skladu sa važećim zakonima koji regulišu relevantna polja za njegovo radno mesto;**
**• Obavljanje zadataka na poslu osiguravajući kvalitet i profesionalnu kompetentnost nastavnog procesa;**
**• Pravilno pripremite nastavni plan i program, u skladu sa jezgrom nastavnog plana i programa.**
**• Primijeniti nove metodologije nastave i procjene u skladu s smernicama kurikuluma;**
**• Održavanje ličnog studijskog časopisa;**
**• Da aktivno učestvuje u vanškolskoj organizaciji sa učenicima i da odgovorno sprovodi izlete sa učenicima u zemlji i inostranstvu, po uputstvima direktora škole;**
**• Da poštuje direktnu nadležnost zvaničnika kome izveštava i da obavlja dužnosti koje on ili ona može dodeliti. Radne dužnosti moraju biti u skladu sa važećim zakonima.**

**Uslovi učešća na takmičenju:**
**Za gore navedene radne pozicije potrebna je profesionalna priprema u skladu sa Administrativnim uputstvom MONT-a br.6 / 2015 Normativ o profesionalnom okviru za opšte obrazovanje.**
**Kandidati moraju da popune sledeću dokumentaciju: odgovarajuću diplomu fakulteta, izvadak rođenja, sertifikat o radnom iskustvu u obrazovanju i kopiju lične karte.**
**Što se tiče slobodnog posla, neophodna je karijera (izborni predmeti): magistarski studij ekonomije ili ekonomije - četverogodišnji sistem, 5 godina radnog iskustva u obrazovanju, izvadak rođenih i kopija lične karte.**
**Svi dokumenti tokom prijave moraju biti kopije, dok original treba da se prikaže na dan razgovora.**
**Rok i način aplikacije.**
**Prijavni formulari su primljeni i dostavljeni Građanskom servisnom centru - Prihvatilištu, prizemlje.**
**Nedovršeni dokumenti podnijeti nakon roka neće biti pregledani.**
**Izbor i kandidati za intervju biće obavešteni putem e-maila ili tablice javnog oglasa.**
**Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u javnim informativnim medijima od 30.06.2018. Do 14.07.2018.**

**Direktor Direkcije**
**Zahir Doda**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Mango", SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 70246042 dhe nr.fiskal: 600362909 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Mango" D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 70246042 i broj fiskala: 600362909 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Mango" L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 70246042, i number fiskal: 600362909 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

### Njoftimi për shprehje të interesit

**Sh.f.m.u "Osman Mani" Firajë Komuna Shtërpcë**
**Data:**29.06.2018
**Emri i kontratës:** Pajisje për kabinetin e IT-së
**Numri i kontratës:** ESIP/SDG/103- ESIP/SDG/103-G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të TeknologjisëSh.f.m.u "Osman Mani në Firajë Komuna Shtërpcë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
   *Furnizimi i shkollës me:* **2 llaptop dhe 1 projektor**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën:

**Sh.f.m.u "Osman Mani fshati Firajë Komuna Shtërpcë më së largu deri më 9 koorik 2018.**

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

5. Detajet kontaktuese të shkollës
**Ganimete Xhemajli**
**Tel: 044 380 029**
**E-mail: ganimetexhemajli@hotmail.com**

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Zana Gashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmgj "Gjon Buzuku" Prizren.

▶ Besnik Kabashaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIll shf "Hysni Temaj" Kushnin.

▶ Besnik Muhadri shpall te pavlefshme diplomën QAP "Dituria" Furtar 2008 Prizren.

▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perlleshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

# Njoftim

Njoftojmë të interesuarit se me datën 12. 07. 2018 (E merkure) me fillim në orën 12:00 Bsc. i dipl. Ylber Hoti mbron punimin e Masterit me titull "Efektet e fraksioneve të farës dhe kapaciteti i endospermës në zhvillimin e fidanëve të grurit në fazën e 12- Zadoks". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333